



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 02/19
Rahovec, 19.02.2019

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
27 Shkurt 2019 (e mërkurë) me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dalje në debat publik të Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pronave për rrugën tranzitë në Rahovec,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2019.
7. Informatë mbi Kontratat kornizë të Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
8. Informatë rreth Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2019,
9. Informatë rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018.


KRYESUESI I KUVENDIT

Afrim Dina



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Neni 10 paragrafi 2.3 neni 40 paragrafi 2.1 dhe neni 46 paragrafi 1, i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve.
 2. Të drejtë për pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
 3. Për datën, vendi dhe koha e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
 4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
 5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Administratë, zyra e Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe Qendra për Punë Sociale në Rahovec..
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.
- *Anëtarëve të Kuvendit ,*
 - *Shërbimit të Kuvendit,*
 - *MAPL-së*
 - *Arkivi*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC


01. Nr
Rahovec, 27.02.2019

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. Protokolit: 01/44/19
Më datë: 06.02.2019
Rahovec, 2019

DRAFT-PROPOZIM
RREGULLORE NR. 01/2019
PËR
REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Rahovec, Janar 2019

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja i) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), nenit 98 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01.12.2010), Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës të datës 20.11.1989, nenit 12 paragrafi 2 pika 2.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës i propozon këtë:

DRAFT- RREGULLORE
PËR
REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton masat dhe veprimet e domosdoshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë fëmijët pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndonjë mendimi tjetër, origjinës kombëtare, përkatësisë etnike, pasurisë, aftësisë së kufizuar, prejardhjes familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjor dhe shtrihet në të gjitha institucionet të cilat janë nën administrimin e Komunës së Rahovecit apo veprojnë në nivel komunal, përderisa pavarësia e tyre nuk cenohet në kundërshtim me ligjin.

Neni 2
Përkufizimi i fëmijës

1. **Fëmijë** – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.
2. **Fëmijë me aftësi të kufizuar** - nënkupton fëmijët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërveprim me barrierat të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.
3. **I mitur** - nënkupton fëmijën mes moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet
4. Fëmijët janë një kategori e veçantë e personave të cilët për shkak të moshës, zhvillimit fizik, intelektual dhe pjekurisë duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve. Prindërit, familjet, kujdestarët dhe institucionet qeveritare mbajnë përgjegjësinë kryesore për

realizimin e të drejtave të fëmijëve për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore para dhe pas lindjes së tyre.

5. **Puna e lejuar për fëmijë** - është pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet.
6. **Puna e ndaluar për fëmijë** - është puna apo aktiviteti, i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës
7. **Organi i Kujdestarisë** – është organ komunal profesional kompetent për çështjet sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale. (koment nga QPS)
8. **Ekipi** - nënkupton Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Neni 3

Parimet e përgjithshme të të drejtave të fëmijës

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës të datës 20.11.1989 (në tekstin e mëtejshëm Konventa) i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejtat e fëmijës në mënyrë të plotë siç janë përcaktuar në konventë.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni dhe aktet nënligjore udhëhiqen nga parimet e Konventës:
 - a. **Mosdiskriminimi** që nënkupton se të gjithë fëmijët brenda juridiksionit lokal i gëzojnë të drejtat e barabarta pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare apo sociale, statusit ekonomik të fëmijës, prindërve apo kujdestarit ligjor.
 - b. **Interesat më të mira të fëmijës** që nënkupton se në rast të ndonjë vendimi nga ana e institucioneve së pari do të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës i cili është subjekt i vendimit.
 - c. **E drejta e jetesës, mbijetesës dhe zhvillimit** që nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, social dhe kulturor.
 - d. **Pikëpamjet e fëmijës**, që nënkuptojnë lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet që lidhen me ta, si dhe obligimin e institucioneve për t'i dëgjuar këto pikëpamje dhe për t'i marrë parasysh ato kur të marrin vendime që ndikojnë tek këta fëmijë, gjithmonë në përputhje me nivelin e zhvillimit të fëmijës.
3. Parimet e Konventës zbatohen në mënyrë direkte në legjislacionin vendor.

Neni 4 Komuna

1. Komuna është institucioni i qeverisjes lokale, dhe përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe rintegruese për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të saj, sipas standardeve dhe politikave të përcaktuara me konventa ndërkombëtare.
2. Komunitet përgatit plane vjetore dhe financim përkatës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.
3. Komuna i garanton secilit fëmijë që:
 - 3.1. Të ndikojë apo të marrë pjesë në vendimet e Komunitetit të vet;
 - 3.2. Të shprehë pikëpamjet për Komunitetin;
 - 3.3. Të marrë pjesë në jetën familjare, të komunitetit dhe jetën sociale;
 - 3.4. Të marrë shërbimet kryesore si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe kujdesi alternativ;
 - 3.5. Të pijë ujë të pastër dhe të ketë qasje në higjienën e duhur;
 - 3.6. Të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër cënues për shkak të moshës apo gjinisë;
 - 3.7. Të ecë i sigurtë në rrugët e qytetit;
 - 3.8. Të takohet dhe luajë me shokët;
 - 3.9. Të ketë hapësira të gjelbra për bimët dhe kafshët;
 - 3.10. Të jetojë në një mjedis të pastër;
 - 3.11. Të marrë pjesë në ngjarjet kulturore dhe sociale;
 - 3.12. Të jetë një qytetar i barabartë i Komunitetit, me qasje në secilin shërbim, pavarësisht nga përkatësia etnike, feja, të ardhurat, gjinia apo aftësia.

II. DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 5 Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijës

1. Realizimi i të drejtave të fëmijës është përgjegjësi kryesore e familjes dhe llogaridhënie morale dhe e vetë-imponuar e institucioneve qeveritare;
2. Çdo zyrtar publik, secili institucion komunal, çdo institucion në nivel qendror që vepron në nivel komunal dhe çdo subjekt tjetër që lidhet me fëmijët – të gjithë kanë përgjegjësi sociale

dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës, në përputhje me konceptin e Komunës.

3. Lista e palëve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në Komunë përfshin (por nuk kufizohet në) këto palë:

- 3.1. Zyra e kryetarit të Komunës, kuvendi dhe drejtoritë e Komunës;
- 3.2. Ministritë e linjës me kompetenca të deleguara ose të zgjeruara;
- 3.3. Organet e drejtësisë për fëmijë (policia, gjykata, prokuroria, shërbimi i lirit me kusht, etj);
- 3.4. Mekanizmat koordinuese për mbrojtjen e fëmijëve në nivel të Komunës;
- 3.5. Njësia për të drejtat e njeriut/fëmijës në Komunë;
- 3.6. Qendra për punë sociale;
- 3.7. Institucionet shëndetësore;
- 3.8. Shkollat, përfshirë të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar;
- 3.9. Klubet dhe shoqatat sportive dhe artistike;
- 3.10. Institucioni i avokatit të popullit (Ombudspersonit);
- 3.11. Shoqatat dhe këshillat e prindërve;
- 3.12. Organizatat e shoqërisë civile;
- 3.13. Zyrat dhe njësitë e organizatave ndërkombëtare në Komunë;
- 3.14. Shoqatat profesionale;
- 3.15. Organet tjera (formale dhe joformale) që si qëllim parësor kanë promovimin e mbrojtjes së përgjithshme sociale dhe mirëqenies të të gjithë fëmijëve;

Neni 6

Mekanizmat koordinuese për të drejtat e fëmijës

1. Mekanizmi koordinues i Komunës shërben si një platformë apo rrugë për vendosjen e prioriteteve dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë për formësimin e çështjeve dhe zgjidhjeve për fëmijë, veçanërisht për vënien në praktikë të angazhimeve dhe veprimeve të politikave ekzistuese.
2. Mekanizmi koordinues i Komunës krijon një mjedis mundësues për përgatitjen e planeve të veta për zhvillim, alokon buxhetet dhe monitoron zbatimin e programeve të tyre përkatëse.
3. Kryetari i Komunës emëron kryesuesin e mekanizmit koordinues dhe është përgjegjës për angazhimet e Kuvendit të Komunës për politikën dhe shërbimet për fëmijë.

4. Komuna, me një vendim të veçantë, përcakton mekanizmat koordinues për realizimin e të drejtave të fëmijës në sistemin e qeverisjes komunale, përfshirë kushtet e punës të përkufizuara për rolet, përgjegjësitë dhe rregullat e procedurës.
5. Ky mekanizëm është i përbërë nga palë dhe institucione të ndryshme dhe në të përfaqësohen edhe njësi të ndryshme si dhe grupe të tjera formale dhe joformale. Përbërja e këtij mekanizmi përcaktohet nga akti i themelimit të mekanizmit me kushtet e punës të përkufizuara.
6. Mekanizmi duhet të:
 - 6.1.Promovojë konceptin e Komunës dhe praktikat e përkufizuara sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara;
 - 6.2.Sigurojë koordinimin e politikave të cilat ndikojnë tek fëmijët;
 - 6.3.Sigurojë që të gjitha aspektet e kornizës ligjore të cilat janë nën kontrollin e Komunës i promovojnë dhe i mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Ndërkohë, të veprojnë si një mbështetës i fuqishëm i fëmijëve duke ndikuar në legjislacionin mbi të cilin nuk ka kontroll (ai në nivel vendi) të bëjë të njëjtën gjë;
 - 6.4.Kryej vetëvlerësime periodike të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga Komuna në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë;
 - 6.5.Udhëheqë procesin e hartimit të një strategjie komunale dhe një plani të veprimit për fëmijë në baza vjetore dhe të vëzhgojë zbatimin e tij bazuar në vetëvlerësimin komunal;
 - 6.6.Strategjitë komunale dhe planet e veprimit, *sikur që është strategjia e propozuar e Qendrës për Punë Sociale në kuadër të Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për organizimin e Qendrës për qëndrim ditor të fëmijëve me nevoja të veçanta (koment nga QPS)*si dhe për të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, hyjnë në fuqi nga vendimi i Kryetarit të Komunës.
 - 6.7.Sigurojë një sistem komunikimi që mundëson rrjedhën e informacionit ndërmjet pikëpamjeve të fëmijëve që konfirmon se janë duke u respektuar në punën e tij dhe në punën e mbarë qeverisjes në nivel komunal;
 - 6.8.Sigurojë sistem komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njësive specifike të institucioneve relevante, përgjegjëse për çështjet e fëmijëve;
 - 6.9.Bëjë rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
 - 6.10. *Komiteti Lokal i Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave të rënda për fëmijët, i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës, do të bashkëpunojë ngushtë me Mekanizmin Koordinues dhe organizma tjerë që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve në Komunën e Rahovecit. (koment nga QPS)*
7. Mekanizmi nuk e përjashton krijimin e organeve, ekipeve dhe mekanizmave të tjerë, në vartësi të këtij mekanizmi, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, mekanizmi koordinues duhet t'i mbajë marrëdhëniet me mekanizmat tjerë dhe të raportojë mbi punën e tyre dhe të marrë këshilla dhe rekomandime nga mekanizmat tjerë koordinues.
8. Mekanizmit koordinues i jepet autoriteti më i lartë i Komunës, sepse ai i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës.

Neni 7

Vlerësimi i ndikimit tek fëmijët

1. Komuna zhvillon një proces për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit dhe programeve për fëmijë në jetët e fëmijëve. ???
2. Ky proces vlerëson situatën e të gjithë fëmijëve, me vëmendje të veçantë tek fëmijët nga grupet e pa favorizuara *e posaçërisht dhe jo vetëm, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe fëmijët e braktisur (koment nga QPS).*
3. Sigurohet që vlerësimi i ndikimit tek fëmijët fillon mjaft herët, gjatë analizës së situatës dhe formulimit të ndërhyrjeve për të pasur ndikim në vendim-marrje.
4. Kryen një vlerësim të rregullt të ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët.
5. Sigurohet një hapësirë për procesin e pavarur të vlerësimit në lidhje me ndikimin e politikave në praktikën dhe shërbimet *sociale* për fëmijë.

Neni 8

Sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve

1. Kryetari i Komunës (kryesuesi/ja e mekanizimit koordinues) i raporton Kuvendit të Komunës për të siguruar funksionimin efektiv të mekanizmit të koordinimit dhe raportimin e rregullt mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve.
2. Mekanizmi koordinues komunal, i përcakton treguesit dhe të dhënat që janë prioritet të Komunës për fëmijët dhe interesat e tyre. Ky mekanizëm obligon Komunën të raportojë në mënyrë periodike mbi treguesit dhe të asistojë në monitorimin dhe vlerësimin e progresit për një komunë mike për fëmijë.
3. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatëse, të lidhura me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të të drejtave të fëmijëve. ~~Në rast kur Komuna nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ata janë të obliguar t'i sigurojnë ato në bashkëpunim me nivelin qendror. Qendra për Punë Sociale, do t'i dorëzojë Mekanizmit Koordinues, të dhënat lidhur me aktivitetet e saj sipas mandatit ligjor që ka për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve (koment nga QPS).~~
4. Komuna e cakton njësinë përgjegjëse në Komunë për të nxjerrë të dhëna të rëndësishme dhe raportim të rregullt mbi statusin e treguesve për të drejtat e fëmijëve, të cilët sigurohen nga institucionet përgjegjëse komunale dhe u raportohet zyrtarisht në bazë vjetore.
5. Komuna i shfrytëzon në mënyrë efektive raportet për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetin për fëmijë dhe duke u bazuar në nevojat kërkon nga njësitë përgjegjëse t'i përditësojnë të dhënat dhe raportimet në çdo kohë.

6. Bazuar në trendet e zhvillimit komunal, Komuna i shqyrton treguesit dhe raportin periodikisht në mënyrë që t'i rishikojë ato bazuar në nevoja.

Neni 9

Buxheti për fëmijë

1. Komuna zhvillon një proces për analizimin e nevojave të buxhetit për fëmijët e Komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:
 - 1.1. Identifikimin nëse fëmijët janë duke i pranuar pjesët e duhura të burimeve për investime publike, në shërbime ku shpërndarja administrohet nga niveli i vendit;
 - 1.2. Analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të zbulohet pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen dëshmitë e gjeneruara për të investuar në fëmijë;
2. Komuna zhvillon një proces për planifikim të buxhetit komunal i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët, duke i përfshirë edhe fëmijët. Ky buxhet i reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë në të gjitha aspektet e qeverisjes komunale.
3. *Komuna, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale do të planifikojë buxhetin e posaçëm për fëmijët pa mbështetje prindërore dhe për Familjet Strehuese të cilat me vetëmohim dhe me përkushtim rrisin, ushqejnë dhe kujdesen për fëmijët e braktisur (koment nga QPS).*

Neni 10

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

1. Komuna ndërmerr masa të qarta në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit.
2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve përfshijnë (por nuk kufizohen në):
 - 2.1. Organizmin e trajnimeve mbi të drejtat e fëmijëve për udhëheqësit komunal dhe zyrtarët kryesorë;
 - 2.2. Përfshirjen e mësimin rreth të drejtave të fëmijëve dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në të gjitha nivelet e kurrikulave të shkollës;
 - 2.3. Përfshirjen e mësimin dhe promovimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit për persona të cilët punojnë me ose për fëmijë.
 - 2.4. Vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve;
 - 2.5. Promovimin e punës së *Organit të Kujdestarisë të QPS-së dhe (koment nga QPS) institucioneve tjera të cilat e kanë për mandat ligjor promovimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.*

3. Komuna krijon partneritete me institucionet qendrore sipas standardeve të përcaktuara nga MPMS-DPSF (koment nga QPS) dhe gjithashtu me organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve.

Neni 11

Avokimi i pavarur për fëmijë

1. Komuna krijon një sistem të qëndrueshëm të partneritetit me një spektër të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura të cilat avokojnë për të drejtat e fëmijëve.

Në këtë drejtim:

- 1.1. Organizatave joqeveritare të licencuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, (koment nga QPS) u jepet mbështetje adekuate për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrje në mënyrë të pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve;
 - 1.2. Inkurajohen dhe mbështeten organizatat e të rinjve dhe fëmijëve;
 - 1.3. Lehtësohet themelimi i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve;
 - 1.4. Mbahen komunikime të rregullta me OJQ-të dhe institucionet e pavarura, në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në Komunë.
2. Kuvendi i Komunës organizon të paktën një seancë vjetore për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijës duke iu referuar raportit të situatës për fëmijë (Neni 8, pika 4 e kësaj rregulloreje).
 3. Komuna organizon “ditët e hapura për fëmijë” (të paktën 3 ditë në vit) dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijës.
 4. Komuna në bashkëveprim, dhe jo vetëm, në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe QPS-së organizon këshillime dhe ligjërata nëpër shkolla dhe ambiente të fëmijëve, me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të fenomeneve të këqija në mesin ku jetojnë dhe mësojnë (koment nga QPAS).

Neni 12

Pjesëmarrja e fëmijës

1. Komuna siguron pjesëmarrje aktive të fëmijëve në rastet me interes për ta, në çdo proces vendim-marrës. Të gjithë zyrtarët publikë, institucionet dhe njësitë komunale institucionale, janë të obliguara ta pasqyrojnë këtë në punën e tyre.
2. Institucionet edukative e mundësojnë mësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive përmes kurrikulës së shkollës dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe në koordinim me institucionet e sektorëve përkatës të cilët janë drejtpërdrejt në kontakt me fëmijët gjatë ofrimit të shërbimeve për ta (shëndetësia, mirëqenia sociale, drejtësia etj.).

3. Institucionet edukative, sportive dhe kulturore e nxisin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, klubeve sportive, artistike dhe kulturore, etj.
4. Organet administrative dhe gjyqësore në Komunë në rastin e vendim-marrjes për rastet që ndikojnë tek fëmijët, i marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e fëmijëve, dhe në përputhje me praktikën dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues dhe i përshtatshëm për moshën e tyre.
5. Pjesëmarrja kuptimplotë e fëmijëve sigurohet në procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve, politikave dhe praktikave tek fëmijët, në procesin e raportimit për gjendjen e fëmijëve në Komunë, në procesin e buxhetimit për fëmijë si dhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve për fëmijë dhe të rritur.
6. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve, Komuna e merr parasysh dhe bashkëvepron rregullisht me Asamblenë komunale të fëmijëve si organ primar në Kuvendin Komunal që i përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve, në veçanti të atyre më të cenuarëve.

Neni 13 Ndalesat

1. Aktivitetet e përgjithshme dhe sektorët me prioritet për tu ndaluar:
 - 1.1. Ndalohet puna e natës për të rinjtë nën moshën 18 vjeç prej orës 22 deri në ora 6 të mëngjesit;
 - 1.2. Ndalohet ngritja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F);
 - 1.3. Ngritja dhe bartja e vazhdueshme e peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);
 - 1.4. Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura;
 - 1.5. Puna në lartësi mbi 2 m;
 - 1.6. Ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ndaj zhurmës dhe dridhjes;
 - 1.7. Ekspozimi ndaj substancave toksike;
 - 1.8. Ekspozimi ndaj substancave biologjike;
 - 1.9. Ekspozimi ndaj radioaktivitetit;
 - 1.10. Ekspozimi ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave;
 - 1.11. Ndalohet çdo përdorim i substancave të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin të rregullt dhe normal të fëmijëve (koment nga QPS).

Neni 14

1. Ndalohet puna e menjëhershme për fëmijët nën moshën 18 vjeç në këto sektore:
 - 1.1. Bujqësia ku përfshihen: puna në ujitje, operimi me makina bujqësore, puna me pesticide dhe spërkatja, korret, punë të rënda fizike në fusha dhe hapja e gropave për pyllëzim ose mbjellje të pemëve, hapja e puseve (kanaleve), prerja e drunjëve dhe përpunimi i drurit,

- puna në thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit, gjuetia dhe peshkataria, grumbullimi i frutave malorë dhe vjelja e pemëve, puna në serre dhe puna në bletishtë;
- 1.2. Puna në rrugë ku përfshihen: bartja e peshave të rënda, pastrimi i parafrangëve të automjeteve në komunikacion, kërkimi i lëmoshës, shitja e gjësëndeve ushqimore, duhanit, etj;
- 1.3. Puna në ndërtimtari siç janë: gjermimi i dheut, transportimi i peshave të rënda, shitja e rërës dhe çimentos, puna në skela, etj;
- 1.4. Puna në deponi të mbeturinave siç janë: hulumtimi, grumbullimi dhe bartja e mbeturinave;
- 1.5. Puna në eksploatimin e pasurive natyrore siç janë: gjermimet sipërfaqësore të thëngjillit, rërës dhe gurëve, eksploatimi i thëngjillit, rërës dhe gurëve.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Procedurat për zbatimin e Rregullores

1. Mekanizmi i koordinimit (ose ndonjë organ tjetër komunal ose i pavarur) e monitoron zbatimin e rregullores dhe harton raporte vjetore.
2. Kuvendi Komunal diskuton raportet dhe bazuar në këtë miratim merr vendime për masat eventuale për sigurimin e zbatimit të tij të plotë.
3. Në rast të shkeljes së detyrave lidhur me zbatimin e Rregullores nga zyrtar publik, organet përkatëse komunale marrin masa adekuate në pajtim me procedurat komunale.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozitat ligjore.
2. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.





KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

Të nderuar,

Konform Nenit 38. të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të bashkangjitur keni, **Kontrata e nëshkruar Kornizë për vitin 2018 nga Zyra e Prokurimit Rahovec:**

1. **TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK**
Numri i Prokurimit: 623-18-1722-1-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-008-1-2-1
2. **TITULLI I KONTRATËS: NDËRTIMI I SERAVE ME PARTICIPIM (80 %:20 %) – RITENDERIM**
Numri i Prokurimit: 623-18-6288-5-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-018-5-2-1
3. **TITULLI I KONTRATËS: MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE**
Numri i Prokurimit: 623-18-3477-5-1-1
Numri i Brendshëm: 623-18-023-5-1-1
LOT I – MEREMETIMI I RRUGËVE ME ASFALT NË KOMUNËN E RAHOVECIT
4. **TITULLI I KONTRATËS: MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE**
Numri i Prokurimit: 623-18-3477-5-1-1
Numri i Brendshëm: 623-18-023-5-1-1
LOT II – MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE ME KUBËZA NË KOMUNËN E RAHOVECIT
5. **TITULLI I KONTRATËS: MEREMETIMI I RRUGËVE DHE TROTUAREVE**
Numri i Prokurimit: 623-18-3477-5-1-1
Numri i Brendshëm: 623-18-023-5-1-1
LOT III – NDËRTIMIN E MUREVE MBOJTESE
6. **TITULLI I KONTRATËS: SINJALIZIMI VERTIKAL DHE HORIZONTAL I RRUGËVE**
Numri i Prokurimit: 623-18-3332-5-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-024-5-2-1
7. **TITULLI I KONTRATËS: RRËNIMI I OBJEKTEVE PA LEJE SI DHE OBJEKTEVE TË VJETRA NË KOMUNËN E RAHOVECIT – RITENDERIM**
Numri i Prokurimit: 623-18-5634-5-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-027-5-2-1
8. **TITULLI I KONTRATËS: MIRËMBAJTJA E NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-4613-5-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-036-5-2-1

9. **TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIM ME MATERIAL TEKNIK PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-4762-1-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-038-1-2-1
10. **TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIM ME DRU, THËNGJILL DHE PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-4860-1-1-1
Numri i Brendshëm: 623-18-039-1-1-1
Lot I – Furnizim me dru për nevojat e Komunës së Rahovecit
11. **TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIM ME DRU, THËNGJILL DHE PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-4860-1-1-1
Numri i Brendshëm: 623-18-039-1-1-1
Lot III – Furnizim me lëndë djegëse - Pelet për Shkollat në Komunën e Rahovecit
12. **TITULLI I KONTRATËS: INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-5337-2-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-042-2-2-1
INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Loto I
13. **TITULLI I KONTRATËS: INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-5337-2-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-042-2-2-1
INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Loto II
14. **TITULLI I KONTRATËS: INVESTIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAT E DËSHMORËVE DHE CIVILE NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Loto III – RITENDERIM**
Numri i Prokurimit: 623-18-7056-2-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-042-2-2-1
15. **TITULLI I KONTRATËS: MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE KAPITALE**
Numri i Prokurimit: 623-18-5814-2-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-046-2-2-1
16. **TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIMI DHE INSTALIMI I KAMERAVE NË OBJEKTET E KOMUNËS SË RAHOVECIT**
Numri i Prokurimit: 623-18-7582-1-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-062-1-2-1
17. **TITULLI I KONTRATËS: MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE**
Numri i Prokurimit: 623-18-9035-2-2-1
Numri i Brendshëm: 623-18-073-2-2-1
MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE – Loto I

18. TITULLI I KONTRATËS: MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE

Numri i Prokurimit: 623-18-9035-2-2-1

Numri i Brendshëm: 623-18-073-2-2-1


MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE – Loto II

19. TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Numri i Prokurimit: 623-18-9532-1-2-1

Numri i Brendshëm: 623-18-078-1-2-1


Me respekt,
Jetulla Kabashi,
Zyrtari i Prokurimit





KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

Për:	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Nga:	Jetulla Kabashi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit – Komuna Rahovec
Lënda:	Planifikimi i Prokurimit për vitin 2019
Datë:	30/11/2018



I nderuar Kryetar,

Konform Nenit 8. të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të bashkangjitur keni Planifikimin të Prokurimit për vitin 2019. Planifikimi është pregaditur pas kërkesës që Zyra e Prokurimit i ka bërë njësive dhe të dhënave që ka pranuar nga njësitë.

Me respekt:

Zyra e Prokurimit

Jetulla Kabashi
Shef i Zyrës së Prokurimit/Komuna Rahovec
Adresa: Rr. "Xhelal Hajda - Toni" p.n. 21000 Rahovec
Tel: 045 884 536 e-mail: prokurimi.rahovec@gmail.com



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
ZYRA E PROKURIMIT
PROCUREMENT OFFICE

PLANIFIKIMI PËRFUNDIMTAR I PROKURIMIT

Sipas Nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për vitin Fiskal

2019

[Planifikimi përfundimtar i Prokurimit duhet të plotësohet dhe të derghohet në AQP jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes së legjislacionit të përvetësimeve.]

Data e dergimit në
ZKA 30.11.2018

E rezervuar për AQP

Planifikimi paraprak X

Data e pranimit:

NENI I. Identifikimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Emri i AK		Personi	
		kontaktes:	Jetulla Kabashi
Adresa	KOMUNA E RAHOVECIT	e-mail-i:	prokurimi.rahovec@gmail.com & prokurimi.rahovec@rks.gov.net
Qyteti	Rt. "Xhelal Hajda - Ton" p.n.	Kodi Postar	21000
Telefoni	Rahovec	Regjioni	Prizren
email-i	045/884-536	Faksi	N/A
		URL:	N/A

NENI II. Përkthimi përmbljedhës i kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal

III.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përfaqët Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
28000000-2	Pajisje për zërim në Shtëpinë e Kulturës Mensur Zyberaj	1		Komplet			5,000.00	2 Shkurt
28000000-2	Furnizimi i shkollave me teknologji informative	1		Komplet			10,000.00	15 Shkurt
28000000-2	Furnizim i bibliotekave me libra-vazhdim	1		Komplet			10,000.00	29 Mars
28000000-2	Blerja e teknologjisë informative	1		Komplet			2,000.00	15 Prill
28000000-2	Blerja e veturave për Inspektor - I Ri	1		Komplet			5,000.00	22 Prill
28000000-2	Vegla, pajisje dhe uniforma për zjarrofikës (vazhdim)	1		Komplet			8,000.00	13 Qershor
28000000-2	Furnizim me inventar, pajisje teknologjike mjeksore dhe mirëmbajtja e tyre-vazhdim	1		Komplet			30,000.00	19 Qershor
28000000-2	Digjitalizimi i Rëntgenit	1		Komplet			25,000.00	21 Qershor
Totali							95,000.00	

III.2) KONTRATAT PËR SHERBIME

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përkthimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
65000000-3	Mirëmbajtja e automjeteve të Komunës së Rahovecit	50,000.00	14 Janar
65000000-3	Konsulencë për hartimin e projekteve për fermerë	30,000.00	01 Shkurt
65000000-3	Hartimi i projekteve të ndryshme (vazhdim)	20,000.00	01 Shkurt
65000000-3	Hartimi i planit lokal të veprimit në mjedis	10,000.00	07 Mars
65000000-3	Dezinsektimi, Dezinfektim dhe Derratizim - Vazhdim	30,000.00	25 Prill
65000000-3	Sigurimi i Objekteve shëndetësore nga fatkeqësit natyrore	10,000.00	14 Maj
65000000-3	Sigurimi i Automjeteve të Komunës së Rahovecit	11,000.00	9 Gusht
Totali		161,000.00	

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përkthimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
45000000-7	Intervenimet emergjente në infrastrukturë (vazhdim)	30,000.00	14 Janar
45000000-7	Furnizimi me Gypa PVC	20,000.00	05 Shkurt
45000000-7	Ndërtimi i semaforëve të rinjë	20,000.00	11 Shkurt
45000000-7	Krijimi i parkingjeve të reja në Qytet	20,000.00	27 Shkurt
45000000-7	Ngrahje qëndrore për shkollat e komunës së Rahovecit	31,513.00	28 Shkurt
45000000-7	Ndërtimi i E- Kioskut	5,000.00	15 Mars
45000000-7	Ndërtimi i shkollës fillore në Fortesë	80,000.00	15 Mars
45000000-7	Drenazhimi dhe hidroizolimi i objekteve shkollore	10,000.00	20 Mars
45000000-7	Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit Hardh Fest - Faza e Dytë	30,000.00	5 Prill
45000000-7	Rregullimi i terreneve sportive- vazhdim	10,000.00	10 Prill
45000000-7	Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve	10,000.00	17 Prill
45000000-7	Përkrahje e Fermerëve në Komunën e Rahovecit (mekanizëm bujqësor, inpute bujqësore, farëra, plehra kimikë, etj.)	90,000.00	19 Prill
45000000-7	Vazhdimi i ndërtimit të shtëpisë muze Ukshin Hoti-faza e dytë	30,000.00	24 Prill
45000000-7	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore - vazhdim	190,000.00	30 Prill

45000000-7	Aplikimi i masave të EE-së - Ndriçimi publik në qytetin e Rahovecit (vazhdim)	40,000.00	30 Prill
45000000-7	Përkrahje për biznese	20,000.00	10 Maj
45000000-7	Ndërtimi i Çerdhës në Krushë të Madhe	50,000.00	15 Maj
45000000-7	Stalla dhe ferma të vogla për fermerë	20,000.00	17 Maj
45000000-7	Investime në zonën ekonomike në Apterushë - Vazhdim	20,000.00	20 Maj
45000000-7	Kanali i kullimit të tokave bujqësore në komunën e Rahovecit - vazhdim	38,000.00	24 Maj
45000000-7	Ndërtimi i QMF-së në Qifllak	30,000.00	28 Maj
45000000-7	Ndërtimi i shtëpive dhe material ndërtimor për familje në nevojë	35,000.00	28 Maj
45000000-7	Investime në terrene sportive dhe infrastrukturën kulturore	20,000.00	30 Maj
45000000-7	Rregullimi i shesheve dhe objekteve me rëndësi të veçantë	60,000.00	30 Maj
45000000-7	Participimi në projekte me bashkëfinancim në Bujqësi - vazhdim	60,000.00	31 Maj
45000000-7	Ndërtimi i Çerdhës në Xerxë	30,000.00	1 Qershor
45000000-7	Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe drunj dekorativë	60,000.00	5 Qershor
45000000-7	Riparimi i objekteve të gjendjes Civile	5,000.00	7 Qershor
45000000-7	Ndërtimi i shtëpisë së pleqve	20,000.00	15 Qershor
45000000-7	Ndërtimi i busteve, lapidarëve dhe pllatove të dëshmoreve (vazhdim)	20,000.00	15 Qershor
45000000-7	Përkrahja e Projekteve për OJQ për zhvillim Rural	20,000.00	18 Qershor
45000000-7	Ndërtimi i Kullës prej guri për heronjë - Opterushë	30,000.00	20 Qershor

45000000-7	Restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruarit në K. e Madhe	5,000.00	20 Qershor
45000000-7	Sistemi i ujitës në Komunën e Rahovecit	45,000.00	28 Qershor
45000000-7	Kanali i kullimit të tokave bujqësore në fshatrat Celline dhe Fortes Lot - vazhdim	35,000.00	29 Qershor
45000000-7	Ndërtimi i shkollës fillore në Kaznik	10,000.00	30 Qershor
45000000-7	Tregu i gjelbërt ditor	30,000.00	20 Korrik
45000000-7	Investime në turizem dhe shtigje të ecjes	20,000.00	25 Korrik
45000000-7	Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec	5,000.00	29 Korrik
Totali		1,304,513.00	

II.4) KONKURSET E PROJEKTIMIT

Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
65000000-3	Hartimi i projektit për kompleksin Muzeal të Ukshin Hotit në Krushë të madhe	15,000.00	1 Mars
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
		0.00	
Grand Totali		15,000.00	



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orlovača/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



PLANI I VEPRIMIT PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
JANAR-DHJETOR 2019

Nr. Re.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përgauti	Shqyrton 1	Shqyrton 2	Informon	Vërejtje
1.	Janar	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019, 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak, - Siguria në Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimet dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, 3. Të Ndryshme.	Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës DKA-ja	Anëtarët e propozuar të KKSB-ës	KKSB-së, Kryetari i Komunës	Kuvendin e Komunës	


		1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Trotnaret, liri i tyre dhe shenjat sinjalizuese. - Qentë endacak. - Siguria në Trafik, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimave dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, 2. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, 3. Të Ndryshme.	Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës DSHP, DKA-ja	Kryetari i Komunës Policia KKSB-së	KKSB-së	Kuvendi e Komunës	
		1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimave dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, - Parapërgatitja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarrtë gjatë sezonit veror, 2. Të Ndryshme.	DSHP, Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës DKA-ja	Kryetari i Komunës KKSB-së,	KKSB-së	Kuvendi e Komunës	
3. Prit		1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm,	Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Policia e Kosovës DMSH-ja	Kryetari i Komunës Policia KKSB-së	KKSB-së	Kuvendi e Komunës	

4.	Qershor	- Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit, - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, - Siguria në Trafik, - Gjendja e sigurisë në shkollë, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Rreth veprimave dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit, 2. Sensibilizimi i qytetarëve për rendësin e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturore dhe ndër – fetar. 3. Të Ndryshme.	DAP-ja DKA-ja				
5.	Shkator	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Prishja e qetësisë publike nga lokalitetet natës dhe personat e pa përgjegjshëm - Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë, - Vetëdijësimi nga minat dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer nga lufta, - Gjendja e sigurisë në shkollë - Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkollë dhe zbatimin e planit për siguri në shkollë, - Siguria në trafik. - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje - Rreth veprimave dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,	Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Polica e Kosovës DKA-ja DSHP DSHPSE	Kryetari i Komunës KKSB-së	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	

	2. Të Ndryshme.				
6. Dhetor	1. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik - Përgatitja e planit të veprim për vitin 2020, 2. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, 3. Të Ndryshme.	Shërbimi i Kuvendit-Zyra e Kryetarit Anëtarët e KKSB-së Policia e Kosovës DKA-ja DSHP	Policia KKSB-së	KKSB-së	Kuvendin Komunës

01 Nr. 28/2019
Rahovec, 29.01.2019

Kryetari i Komunës
Shqip Laitif





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBALI

Nr. i prot. 581 / 27.02.19
Br. prot. 28.01.2019

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 28.01.2019 në fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni që ta përshëndes Kryetarin z. Smajl Latifi, nënkryetarin z. Fatmir Iska, monitoruesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, SHL-Kosova, përfaqësuesit e mediave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, delegatët e Kuvendit Komunal dhe gjithë të pranishmit. Jemi në mbledhjen e parë për vitin 2019, ju uroj punë të mbarë dhe suksese. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
5. Shqyrtimi i Informatës mbi Planin e punës të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Komunës së Rahovecit për vitin 2018,
7. Shqyrtimi i Informatës të Plani vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm të KK- Rahovec,
8. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Rekomandimeve për vitin 2018 nga auditori kombëtar (të jashtëm) dhe,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2018.

Kryesuesi - E qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së parë të rendit të ditës. Nëse jo atëherë e qes në aprovim Procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi - A ka ndonjëri nga drejtorët që ti përgjigjet kuvendarëve në pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin dhe ju jap fjalën juve kuvendarëve nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj rreth mirënjohjeve që janë ndarë nga DKRS-ja, një ndër ta e kam marr unë, ju falënderoj për këtë mirënjohje. Drejtoresha e DKRS-së është e re dhe nuk e di se sa ka hulumtuar rreth këtyre procedurave, sa e di unë procedura për ndarje të mirënjohjeve për sportistë duhet të nominohen nga kryetarët të klubeve. Komuna jonë ka shumë sportist të cilët kanë shumë cilësi por kanë mbetur jashtë këtyre mirënjohjeve, e di se nuk munden të marrin të gjithë sportistë mirënjohje, por sa e di në secilën komunë i ndahet 10-të sportistëve çmimi i sportistit të vitit nga sportet e ndryshme. Por pa mirënjohje kanë mbetur shumë sportistë si Durim Gashi, Almir Kryeziu, Qëndrimi dhe shumë e shumë të tjerë mos të i përmendi tani me radhë. Mendoj se është dashur të i motivoni klubet që të i nominojnë këta lojtarë, sepse kur të del në media një njoftim për sportistë të viti është gjynah që këta lojtarë të mos marrin një mirënjohje, kurse të marr duksh tjetër pa kurrfarë merite.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një ankesë rreth hapjes së konkursit për fizioterapeut, kam pyetur në inspektorat dhe sipas tyre QKMF-ja nuk mundet të ketë fizioterapeut sepse nuk i plotëson kushtet. Në konkurs e keni cekur se do të punësohet sipas nevojës, pra kudo që ka nevojë, së pari mendoj se duhet që ti sigurohet vendi i punës në QKMF, pra aty të i sigurohen mjetet e punës, pastaj infermiere sepse atij i duhet ndihmë për të kryer punën ashtu si duhet, e pastaj të përcaktohet kandidati i cili duhet të punojë në atë vend pune. Kjo ishte vetëm si vërejtje, unë do konsultohem edhe me inspektorat në Prishtinë dhe në mbledhjen e ardhshme do të diskutoj rreth kësaj çështje.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po i drejtohem Kryetari të Komunës pasi e kemi prezent në mbledhje, ka një vit që na keni mbetur borxh një mëditje prej 125.00 €, pyetje ime është kur pritët të na lëshohen këto mjete. Në lexim të raportit e pash që mjete komuna kishte pas, besoj se nuk ka pasur nevojë komuna që këto mjete të i bartë diku tjetër, por është dashur të na paguhet ajo mëditje e cila na takon.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet Drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, i nderuar dua ta di se çka bëhet dhe ku shkojnë mbetjet medicinale.

Besmire Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet Drejtorit të DKA-së, këtë vit kur jemi gati në muajin shkurt sipas të dhënave që unë i kamë janë rreth 15 mësues/e në zëvendësim, por ata nuk kanë mar paga që nga muaji tetor, eventualisht shtator, pra Komuna e Rahovecit i ka borxh këtyre 15 mësimeve deri në 5-së paga. Dua ta di se çka është duke bërë Drejtori i DKA-së dhe Drejtori i Financave për ti paguar këto paga këtyre mësimeve.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime i drejtohet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i nderuar drejtor mungesa e ndriçimit publik nëpër lagje të ndryshme si të qytetit ashtu edhe në fshatra është duke krijuar shumë vështirësi për qytetarët e komunës sonë, sidomos mungesa e shtyllave në shkollën e mesme “12 Maji”, krijon frikë gjatë natës për nxënësit të cilët kthehen në shtëpitë e tyre. I nderuar drejtor kur do të filloj vendosja e këtyre shtyllave, ose riparimi i tyre në ato vende ku ka mungesë.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoj një sqarim shtesë nga Drejtori i DKA-së, kemi parë që ka bërë thirrje për ndërprerje të grevës dhe fillim të mësimi, kjo nuk është e një natyre që mundë të mos i pëlqejë dikujt, por në çka e bazon dhe si do ta arsyetojë drejtori këtë kërkesë për ndërprerje të grevës kur e dimë se edhe Sindikata e bashkuar qëndron në anën e mësimeve.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, fillimisht me lejoni të ju uroj një punë të mbarë në vitin 2019, qoftë një vit i suksesshëm për të gjithë. Të nderuar me lejen e Drejtoreshës së DKRS-së do i përgjigjem pyetjes së z. Vahid Krasniqit, i nderuar ne sipas standardeve dhe procedurave e kemi formuar një komision sepse kështu kërkohet, kam përshtypjen se ky komision ka qenë profesional dhe ka bërë vlerësim të drejtë dhe adekuat sa i përket ndarjes së çmimit për sportistë të vitit. Kam qenë dëshmitarë se plotë mirënjohje për plotë meritë u janë dhënë, por e kem përshtypjen se edhe plotë të tjerë që e meritojnë një mirënjohje atë ditë nuk ju është dhënë. Por i nderuar ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në punët e komisionit, e thash se atë ditë kam parë që shumë sportisteve të cilët e kanë merituar atë çmim nuk ju është

dhënë, por herrave të tjera besoj se komisionit duhet vetëm të i bëhet me dije që mos të ketë harresa ose të jetë më gjithëpërfshirës sepse edhe unë kam qenë i pakënaqur sepse kamë parë disa njerëz që kanë qenë prezent aty kam menduar se do të marrin mirënjohje. E nderuar sa i përket konkursit për fizeoterapeut, ndoshta nuk mundë të jetë saktë e precizuar me ligj se çka përmban një QKMF në një komunë e cila i ka 56208 banorë rezident së paku sipas regjistrimit të vitit 2011. Por mendoj se ma shumë se kjo është e rëndësishme se fizeoterapeuti edhe në QKMF por edhe në organizatat joqeveritare që kryejnë veprimtari specifike sikurse që është HAREJA, ose ndonjë organizatë tjetër dhe kanë nevojë për një fizeoterapeut, por ai nuk mundet që ti kryej vullnetarisht shërbimet të cilat deri më tani i ka kryer. Ne e kemi të punësuar një fizeoterapeut me Caritas Kosova dhe besoj se prezenca e më shumë se një është më se e nevojshme për trajtimin e rasteve të cilat kanë nevojë. Ne në organizatën HAREJA kemi mbi 25 persona që janë me aftësi të kufizuara, prandaj mendojmë se ka nevojë për angazhimin e një fizeoterapeuti, bile mendoj se ka nevojë më shumë se sa një. Prandaj nëse është e paligjshme atëherë mendoj se ministria përkatëse do të na jep ndonjë sugjerim ku pastaj mundemi ta trajtojmë në seancat e tjera të kuvendit komunal. E nderuara znj.. Florida Bajraktari ne jemi detyruar që të bëjmë një veprim emergjent në muajin janar sepse siç e dini 1/12 e buxhetit alukohet në muajin janar dhe ne kemi paguar rreth 3,200.00 € kompanisë së Kedsit për të mar lejen për lidhje të rrymës për palestrën e sporteve. E nderuara znj. Hanalora Hoti, e di që tani i kemi dy kompani, njëra mirët me ndërtimin e ndriçimit publik, kurse kompania tjetër merret me mirëmbajtjen e ndriçimit ekzistues publik, ne kemi pasur situata shumë problematike si në qytet ashtu edhe në fshatra, por kompania deri dje e ka stabilizuar bukur mirë gjendjen në qytet, kurse tani ka filluar që të punojë në Krushë të Madhe, Celinë, pastaj do të vazhdojë në Fortesë, Ratkoc, e kështu me radhë. Kurse sa i takon zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik, besoj se këtë vit kemi mundësi me bërë zgjerimin jo vetëm në fshatin Xërxë por ne do të vazhdojmë edhe në fshatrat e tjerë. E nderuara znj. Fahrije Lushi e ngriti shqetësimin sa i përket grevave, e nderuar pavarësisht argumenteve në cilën do situatë unë në cilësinë e Kryetari të Komunës dhe Drejtori i DKA-së në cilësinë e Drejtorit të DKA-së, ne asnjëherë nuk duhet të ndërpremë thirrjen për rifillim të procesit edukativo arsimor, për arsye se jemi bartës të institucioneve dhe për arsye se nuk jemi SBASHKU. Funksionet tona nuk i admirojnë dhe nuk i promovojnë grevat, por i promovojnë pikëpamjet ose thirrjet për ndërprerje të grevave, kurse a janë legjitime apo jo kërkesat e mësimdhënësve e cila nuk është në interes tonë që ta trajtojmë.

Samir Mustafa – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar z. Rasim Fazliu, shkatërrimet e mbetjeve medicinale të QKMF-së bëhet përmes spitalit regional të Gjakovës, sepse ne kemi një kontratë me këtë spital, grumbullimi i këtyre mjeteve bëhet në Gjakovë ku pastaj shkatërrohen po ashtu në Gjakovë.

Avni Morina – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, e nderuara Besmire Bytyqi, së pari duhet të ju them se nuk janë të gjithë 15 punëtorë duke zëvendësuar, ka pasur edhe konkurse të rregullta, që nga muaji shtator e deri më tani kemi pasur një numër të punëtorëve që kanë qenë jashtë listës së pagave, por ne gradualisht gjatë muajve në vijim i kemi futur në listën e pagave, na kanë mbetur edhe 6-7 mësimdhënës. Këto probleme na paraqiten për arsye të rasteve që na paraqiten sepse ne nuk mundemi të dimë se kur mundë të vije në shprehje një pushim i lehonisë ose një pushim mjekësor, por ajo që është një e vërtet e madhe është se që nga fillimi e deri më tani askujt nuk i kemi mbetur borxh, pra në mënyrë retroaktive u janë paguar pagesat për secilin punëtor të arsimit.

Afrim Limani – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, e nderuara znj. Florida Bajraktari, është shumë e vërtet se një pagë ju kemi mbetur borxh, por besoni se gjatë tërë vitit 2018 jam munduar që të ju realizojë këtë pagesë, por sinqerisht nuk kam mundur sepse gjithçka nuk varet nga ne. Kam shpresuar se në muajin dhjetor këtë pagë të ju ekzekutoj por ka qenë e pamundur, por kjo nuk do të thotë se ne jemi dorëzuar dhe do të heqim dorë sepse kjo është një e drejtë që ju takon, por shpresoj se në vitin 2019, pas alokimit të buxhetit do ju realizohet edhe kjo mëditje. Sa i përket mbetjeve që ju e theksuat, e nderuar asambleja

komunale nuk ka pasur mbetje, por ka pasur mbetje tek disa programe tjera, dhe këtë mbetje ne e kemi dërguar në arsim pikërisht për pagesën e këtyre mësimdhënësve.

Faton Ramadani - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të ndërlihem me pyetjen të cilën e parashtroi znj. Besmire Bytyqi, drejtori nuk na e dha arsyen pse ata 15 mësimdhënës kanë mbetur jashtë listë së pagave, për vete e di arsyen pse kanë mbetur jashtë, mendimi imë është se është bërë planifikimi i dobët, shumica e punëtorëve të arsimit kanë mbetur me nga 15 ose 16 ose më pak orë të normës, kurse drejtorja e DKA-së përsëri hapë konkurse të reja.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha sadopak të kontribuoj rreth pyetjes që e bërë znj. Afërdita Thaqi. Nëse e shikojmë dokumentin të cilin e ka aprovuar kuvendi në vitin 2015, pra Statutin e QKMF-së, do të shohim se aty janë shkelur disa nene, konkretisht neni 7 pika 7.5, e cila shpjegon për veprimtarin e QKMF-së, në nivelin primar shëndetësor, po ashtu edhe neni 8 ku e specifikon listën e profesionistëve shëndetësor. Pra niveli primar nuk guxon të del përveç se në rastet e jashtëzakonshme kur e siguron një leje të veçantë nga ministria, po ashtu edhe udhëzimi administrativ për nivelin primar shëndetësor është anashkaluar në kuptimin e dy neneve, nenin 8 dhe nenin 14. Sugjeroj që ky konkurs të rishikohet, të konsultohet ministria relevante, ne e kuptojmë nevojën që të kemi sa më shumë shërbime në nivelin primar apo në perspektivë që ky nivel primar të pasurohet dhe të kalojë në nivele sekondar, por duhet që të ndiqet një rrugë e caktuar, përndryshe besoj se komuna do të bie në një situatë absurde. Do ju japë një shembull të cilin e kemi ndjek me qendrën e dializës, aty si pari e kemi kërkuar një leje ku e kemi arsyetuar me vite, kanë kaluar 2-3 vite derisa ministria relevante dhe shërbimi spitalor e ka lejuar, por kur ka lejuar ka lejuar edhe staf, por përsëri komunës nuk i ka lejuar që të shpallë konkurse për personelin shëndetësor të cilët janë jashtë listës primare, por atë mundësi ja ka deleguar spitalit rajonal. Besoj se edhe tani në këtë rast është dashur të ndiqet kjo rrugë, përsëri uroj që kjo të kalojë në mënyrën më të mirë të mundshme sepse siç e ceku edhe kryetari ne kemi nevojë për fizeoterapeut.

Kryetari – Edhe njëherë dua të ritheksoj se nuk është çështja tek planifikimet e dobëta, zakonisht në arsim e mbaj në mend edhe në mandatin e parë kur kam qenë, por edhe tani ka problem në trajtimin e situatave të cilat kanë të bëjmë me zëvendësime, pajtohem se do të ishte mirë të dihet se kur janë zëvendësimet, por të nderuar jo të gjitha gjërat ne mundemi të i saktësojmë. Planifikimi për vitin 2018 buron nga planifikimi i viti 2017, pra vështirësitë paraqiten sidomos kur ka zëvendësime, qarkorja buxhetore e para dhe e dyta i përcakton limitet, ne jemi të vetëdijshëm për këtë, por ka raste kur ka zëvendësime dhe transfere dhe në këtë mënyrë duhet të shpallim konkurs për 3 ose 6 muaj. Besoj se ata që kanë punuar dhe që janë ende duke punuar nuk do të mbesin pa paga, siç nuk do të mbesin pa paga edhe kuvendarët të cilave u mungon edhe një pagë nga vitit 2018. Pra planifikimi ynë akordohet me orientimet themelore që i ka Ministria e Financave, ne kemi raste kur nuk kemi planifikim të mirë po jo në sistemin e pagave, planifikimet e dobëta janë duke na u paraqitur neve në pozicionet e tjera si në shërbime publike, investime kapitale etj. Sa i përket fizeoterapeutit, ne në qendrën kryesore të mjekësisë familjare kemi specialistë të cilët nuk përkojnë me ligjet, a duhet tani ne ata të i largojmë nga puna, synimet tona janë që të bëjmë edhe mjekësin sekondare dhe këtë askush nuk mundet me ma ndalë mua si Kryetar Komune, po ashtu edhe disa veprimet të njësisë sekondare që të trajtohen në qendrën e mjekësisë familjare. Një nga aspektet e kësaj është edhe reparti i hemodializës i cili ende nuk është aktiv, por është një synim, dhe kjo nuk është bërë kërkesë që 2-3 vite por kërkesa është bërë që plotë 7 vite nga koha kur ka qenë drejtoresh znj. Florije Boshnjaku dhe shqyrr që është bërë në kohën e z. Idriz Vehapit. Edhe një herë por e them nëse Ministria e Shëndetësisë na e kthen neve si të paligjshëm këtë konkurs, ne do ta respektojmë vendimet e organeve më të larta, përndryshe askush nuk e ka të drejtën që të paragjykoj se a është i rregullt konkursi apo jo, pastaj a është i ligjshëm apo i paligjshëm, a është në përputhje me udhëzimin administrativ apo jo. mendoj se kjo që është diskutuar deri më tani nuk është fare temë e kuvendit, por temë e kuvendit është dashur të jetë se a duam ne me e nxjerrë një rregullore e cila afërmon ose promovon që të futen edhe veprimtarit të mjekësisë sekondare në Rahovec.

Faton Ramadani – Tek planifikimi po ju ceki një rast konkret pasi jeni duke thënë se jeni duke planifikuar mirë, pyetje ime është: Pse është dënuar DKA-ja me shumën prej 3,500.00 €, unë e di pse, sepse e keni pranuar një punëtor të ri, kurse punëtorët e ekzistues me nga 5-6 orë kanë konkurruar për këtë vend pune dhe ju nuk i keni pranuar dhe keni marrë punëtor të ri. Të nderuar pse nuk ja keni liru vendin dikujt me hy në listë të pagave me normë të plotë, a nuk është një shembull i keq ky.

Kryetari – Ai i cili e ka bërë këtë gabim ndaj tij do të merren masa administrative, ai do të transferohet diku tjetër, më duket se komisioni disiplinor ka vendosur në rastin konkret. Por mos harroni se kemi plotë raste që edhe njerëzve që nuk kanë pasur normë të plotë ju është kompletuar norma, prandaj për një shembull që nuk është i mirë ju duheni ta pyesni qeverinë komunale se a merrni ju masa, po ju them këtu se do të jem i pamëshirshëm ndaj atyre që gabojnë. Por duhet të dini se edhe unë kontrollohem nga dikush, kontrolli i shtetit është duke u forcuar çdo ditë, prandaj edhe nëse gabojmë ne këtu ata nuk na lejojnë që të gabojmë, pra na tërheqin vërejtjen ose siç e ceket na dënojnë. Pra ne do të përpiqemi që të përmirësojmë kualitetin e punës sonë edhe të planifikimit, edhe të konkurseve dhe gjithçka tjetër.

Afrim Limani – Desha edhe unë të ja japë një përgjigje z. Faton Ramadani në aspektin profesional. I nderuar në pozicionin e pagave buxheti planifikohet në mënyrë të saktë për secilin punonjës, por shtrohet pyetje pse është krijuar ky deficit buxhetor në arsim në vitin 2018, i nderuar kjo ka ndodhur pikërisht, për shkak të pagave jubilarë për tre mësimdhënës për të cilët në vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të planifikuar. Ne jemi detyruar këtyre mësimdhënësve të u paguajmë një shumë përmes përmbaruesit, po ashtu edhe për lehona ka qenë i planifikuar buxheti, por ka qenë e planifikuar një shumë fikse, pra kjo është situata e cila na ka krijuar deficit buxhetor, shpresoj se në vitin 2019 nuk do të kemi kështu situata sepse tre paga jubilarë për punonjësit të arsimit kanë hyrë në buxhetin e vitit 2019, gjithashtu edhe pozicioni për lehona është rritur në një masë të kënaqshme dhe shpresoj se në vitin 2019 nuk do të kemi probleme të këtij lloji.

Fehmi Cena – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, i nderuar pyetje nuk kam, por desha të diskutoj rreth këtij debati që u bërë deri më tani, ne i nderuar duhet të i sqarojmë disa gjëra. Ne si kuvendarë kemi të drejtë të debatojmë në pikën e dytë të rendit të ditës për secilën çështje ose pyetje që parashtrihen nga kuvendarët, mua nuk më pëlqeu forma e ndërhyrjes nga ana e kryesuesit si tek z. Faton Ramadani apo kushdo tjetër, për arsye se ajo ndikon tek të gjithë ne. Po i them edhe disa fjalë rreth konkursit në shëndetësi që u debatuar deri më tani mendoj se më takon të diskutoj, nuk dua të hy andej se a është i ligjshëm apo jo sepse këtë e dinë më mirë juristët. Të nderuar problemi në shëndetësinë e Rahovecit është pamjaftueshmëria e mjekëve të përgjithshëm dhe mjekëve familjar. A mundet të vijë në shprehje edhe fizeoterapeuti, mendoj se po sepse ka nevojë Rahoveci për një fizeoterapeut, por në radhë të parë prioritet mbi prioritetë është mjeku i përgjithshëm dhe mjeku familjar, pra nëse ne kemi mjekë të lirë të cilët nuk punojnë dhe kemi po ashtu AMF dhe QMF ku nuk kanë mjekë, mendoj se është e pakuptimtë me i lënë jashtë pune, pra të i jepet përparësi mjekëve dhe nëse nuk ka mjekë atëherë të i vije radha të tjerëve.

Kryesuesi – Të nderuar unë ju referova asaj që jemi në pikën e dytë të rendit të ditës, sepse është normale që ne kemi ardhur që të debatojmë këtu.

Sali Sallteku – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, jam duke e parë që ky debat ka marrë një kahje që nuk është dashur, dhe ne si kuvendarë kemi marrë qëndrim që secili drejtor të jepe përgjigjen për pyetjet e parashtruara, është duke më u dhimbsur Kryetari i Komunës që është duke e marrë përgjegjësin mbi vete të të gjithë drejtorëve. Është e vërtetë se duhet të bëhet presion nga Kryetari dhe Drejtori i DKA-së për ndërprerjen e grevës, po ashtu edhe disa pyetjeve që u bënë këtu më duket se janë pyetje dytësore, pak ka rëndësi se si shpallen konkursat sepse ato shpallen përmes zyrës së Kryetarit, pastaj edhe nëse është shpallur për një fizeoterapeut mendoj se nuk ka asgjë të keqe këtu, po ashtu konsideroj se nuk ka nevojë më shumë të debatohet rreth kësaj pike.

Kryetari – E falënderoj z. Sali Sallteku i cili na relaksoj pak me diskutimin e tij. Po i përgjigjem z. Fehmi Cenës, i nderuar ne për herë të parë jemi dakorduar me Qeverinë dhe Ministrin e Financave që të ritet për 25

numri i punëtorëve shëndetësor në Rahovec, këtu kemi për të punësuar edhe mjek saqë frikohem se do të kërkojmë mjekë edhe nga komunat e tjera sepse nuk do të ketë mjekë mjaftueshëm aq sa do të kemi mundësi të i punësojmë. Por ne si komunë kemi nevojë edhe për fizeoterapeut dhe infermierë, prandaj besoj se adresimi i shëndetësisë primare si prioritet është i qartë nga ana e jonë.

Kryesuesi – Ju falënderoj të gjithëve për diskutimin e bërë rreth pikës së dytë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Të nderuar anëtarë të kuvendit meqenëse anëtarja e kuvendit si dhe anëtarja e KPF-së znj. Florije Boshnjaku ma datë 03.12.2018, ka dhënë dorëheqje dhe ky vend ka mbetur i lirë, prandaj ne duhet që këtë vend ta plotësojmë me një anëtare tjetër nga radhët e AAK-së. Propozimi i AAK-së është që për anëtare të KPF-së të jetë znj. Fjolla Duraku.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, më lejoni që ta falënderoj kolegen tonë znj. Florije Boshnjaku për kontributin e dhënë gjatë këtyre viteve si anëtare e kuvendit komunal në të gjitha mandatet, po ashtu dhe si anëtare e KPF-së. Propozimi për znj. Fjolla Duraku ka rrjedhë nga grupi i AAK-së prandaj ne i japim mbështetje të plotë këtij propozimi.

Kryesuesi - E qes në votim Plotësim ndryshimit të Vendimit 01 Nr.1025 i datës 29.03.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, me propozimin e AAK-së që si anëtare e re e KPF-së të jetë znj. Fjolla Duraku. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2018.

Kryetari – Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi e prezantoi Raportin vjetor të punës së Qeverisë Komunale për vitin 2018, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit në detaje. Kryetari komunal cekur se pjesa e parë e këtij raporti ka hyrjen, pastaj synimet e politikës në qeverisje, pastaj prioritetet të cilat i kanë vendosur, aktivitetet e rëndësishme që kanë qenë gjatë vitit 2018 ku kanë menduar se duhet të jenë pjesë e këtij raporti, po ashtu janë përfshirë punët e të gjitha njësive që i ka zyra e Kryetarit të Komunës, duke filluar nga Raporti i Zyrës Ligjore, pastaj raporti i njësive të Auditimit të Brendshëm, raporti i Zyrës për Informim, raporti i Zyrës së Prokurimit, raporti i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komitete, njësia komunale për të Drejtat e Njeriut, raporti i Njësive të Personalitetit, raporti i Zyrës për Përfaqësim Ligjor, dhe pastaj e kemi edhe pjesën e Raportimit nga 12 drejtori veç e veç për punën dhe aktivitetet e bërë gjatë vitit 2018.

Kryesuesi – Faleminderit Kryetari për prezantim të këtij raporti, ne këtë raporte e kemi shqyrtuar edhe në KPF, ku kemi dhënë kontributin tonë.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj sa i përket Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, do të citoj disa fjali që i ka cekur kjo drejtori në raport: Raporti i kësaj drejtorie është duke munguar pasi që akoma nuk është përfunduar, arsyeja e mos përfundimit qëndron sepse ende nuk është bërë barazimi me Ministrinë e Financave. Mendoj se kjo drejtori ka mundur të na raportoj sa i përket aktiviteteve të sajë gjatë viteve 2018, numrin e punëtorëve, pastaj synimet e saja cilat kanë qenë, ndërsa këtu e ka cekur se është duke pritur nga MF që të i jep raport. Kurse sa i përket Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, kjo drejtori thotë se kemi përgatitur raportin me pronat komunale në nivel komune ku janë përfshirë mbi 230 prona, mendoj se ky raport duhet të vije në kuvend, pastaj të shihet se si është kryer verifikimi i këtyre parcelave etj. Pastaj më poshtë ceket se në muajt e parë të qeverisjes në zyrën e Kryetarit kemi zgjidhur disa konteste pronësore, mendoj se është dashur të ceket se sa konteste pronësore kanë qenë, pastaj ceket se janë bërë matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare, edhe këtu është dashur të ceket se sa raste të uzurpimit janë gjithsej. Ceket se është përgatitur dokumentacioni detal për të gjitha pronat në nivel komune të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së, ku kemi kërkuar nga agjensioni i AKP-së që ta pezulloj procesin e privatizimit të këtyre pronave, po ashtu kemi kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të

merë një vendim dhe të na i kthejë këto prona në pronësi të komunës e ku sipërfaqja e tyre është mbi 501 hektar, mendoj se edhe këtu është dashur të ceket se për cilat parcela bëhet fjalë.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të pyes rreth vazhdimi të lumit rrinnik në fshatin Fortesë, në raportin e Kryetarit ceket se është bërë vazhdimi i punës, kurse unë kam parë se punimet në këtë lumë janë ndërprerë, pra kjo bie në kundërshtim me raportin. Pastaj mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese, e shohë në raport që e keni cekur se është ndarë një vlerë prej 54,000.00 €, shumë mirë që është ndarë kjo vlerë, por së paku është dashur të ndahet një shumë për pastrimin e shtratit të lumit rrinnik i cili kalon në Fortesë, sepse është duke paraqitur probleme në rrjetin e kanalizimit. Kurse sa i përket DKA-së desha të i drejtohem Drejtorit, në vitin e kaluar e patë nxjerrë një raport në lidhje me mungesat e nxënësve në nivel të komunës, desha ta pyes nëse ka punuar edhe tani në këtë drejtim pse nuk na ka sjellë edhe tani një raport të tillë, në këtë mënyrë do ti kishim parë se a ka përmirësim dhe nëse jo atëherë cilat janë hapat e tjerë të cilat duhet të ndërmerren. Bursat për student i keni ndarë, kam marrë disa shqetësime nga studentët, ku dyshojnë se bursat e studenteve janë ndarë në mënyrë klientliste, ky është një problem që ka ndodhur edhe në kohën e qeverisjes së z. Idriz Vehapit. Kurse sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë ka ankesa rreth furnizimit me barna, kur kemi diskutuar rreth buxhetit ajo që kam kritikuar unë ka qenë kodi për furnizim me barëra sepse ju i keni dhënë përparësi kategorisë së mirëmbajtjes e jo kategorisë për furnizim me barna. Ka qenë një rekomandim nga auditori sa i përket blloqeve dhe participimit të qytetarëve sepse ka pasur një mospërputhje dhe një diferencë jashtëzakonisht e madhe, pyetje ime është a është punuar diçka rreth këtij drejtimi që së paku me i largu disa probleme, ju keni premtuar vitin e kaluar që do të ndërmerrni masa nëse do të ketë shkelje të tilla. Pyetje tjetër është a është koordinuar me spitalin regjional të Gjakovës sepse tani jemi afër ditës botërore kundër kancerit, jam pjesë e institutit onkologjik, dhe jam duke parë që kemi jashtëzakonisht pacientë nga Komuna e Rahovecit të cilët trajtohen në këtë klinik, prandaj kishte me qenë mirë që së paku të bëhet një fushatë sensibilizuese për ngritjen e vetëdijesimit për persona që janë të prekur nga kanceri, ku do ti kishin marrë pjesë shumë gra që janë të prekur nga kanceri i gjirit dhe së paku të i ndihmojmë atyre në këtë fushë, për arsye se kanë mangësi jashtëzakonisht të mëdha, prandaj kërkoj nga drejtori i shëndetësisë që aparati mobilë i mamografisë thuajse që operon në të gjithë Kosovën prandaj kisha kërkuar që të bëhet kjo edhe në Rahovec në mënyrë që shërbimet të jenë sa më afër qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Kam një pyetje për Drejtoreshën e Kulturës e pashë që ka bërë një aktivitet me 150 fëmijë për filma vizatimor, fëmijët janë një kategori jashtëzakonisht e ndjeshme, më vije keq që nuk e ka vazhduar vazhden e këtij aktiviteti, shpresoj se nuk e bënë dallimin Ratkoc, Rahovec, mendoj se është dashur të shkojë Fortesë Krushe e Madhe dhe fshatrat e tjerë sepse edhe ata fëmijë kanë nevojë për relaksim.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2018, desha të ndërlihem në diskutim tek faqe nr. 4 e keni cekur si prioritet është bashkëpunimi i mirë dhe shumë i suksesshëm me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me donatorë të huaj për më shumë përkrahje proceseve zhvillimore të komunës, pyetje ime për Kryetarin e Komunës është: Pse komuna jonë nuk është përfituese e grantit sikurse komunat e tjera.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket Raportit të punës për vitin 2018 tek drejtorja e DKA-së, e keni cekur se i keni pranuar të gjitha tekstet shkollore nga 1-9, si dhe i keni përmendur që kanë munguar tekstet e gjuhës gjermane, por nuk e keni cekur që mungojnë tekstet e gjuhës angleze për klasën e shtatë, sepse kjo ka shkaktuar shumë probleme në realizimin e planit në korikulen e re. Duhet të keni parasysh që kanë mbetur shumë mbrapa në realizimin e detyrave të paraparë me korikulën e re. Pastaj sa i keni planifikuar për këtë vit që ti siguronit tekstet e gjeneratave të përfshira në korikulen e re 6-7-8 dhe cikli u ulët nga 1-3, a do të jenë tekstet kur të filloj viti i ardhshëm shkollor.

Fehmi Cena – Është një raport mjaftë i gjerë, këtu janë të përfshirë të gjitha drejtoritë, ne e kemi pasur vështirësi të koncentrohemi dhe të i analizojmë të gjitha. Në aspektin e përgjithshëm mendoj se ky raport është i detajuar dhe për mendimin tim shumica e atyre punëve që janë realizuar janë të përfshirë në këtë

raport, por atë që ka mungesë ky raport është se nuk janë të përfshirë ato që nuk janë realizuar. Ne nuk e kemi pasur planin e punës paraprakisht që të shohim se çka është paraparë për këtë vit, pastaj çka është realizuar dhe çka nuk është realizuar, një raport do të ishte shumë më i qartë për ne nëse do ti kishte të gjitha këto. Do ja filloj së pari me zyrën e prokurimit, ne nuk jemi të kënaqur me punën e zyrë së prokurimit qa sa duhet, këtë mendim jam duke e dhënë duke u fokusuar nga aspekti i shëndetësisë, është përmendur shumë shpërsh mungesa e barnave, ose furnizimet qoftë me barna qoftë me reagenca, mendoj se këtë përgjegjësi e kanë kjo zyre. Operatorët ekonomik që e fitojnë të drejtën e furnizimit nuk kanë qenë të përgjegjshëm në disa raste, prandaj ne kemi pasur vonesa me këto furnizime, tash në kohë të fundit p.sh kemi mungesë të letrave, recetave, udhëzimeve, mendoj se këtu duhet të shikohet se kush është faj, edhe pse Drejtoria për Shëndetësi duhet të jetë më vigjilente që këto furnizime të jenë më aktive dhe të i jepet vërejtje atyre që nuk janë në nivel. Tek raporti i zyrës për barazi gjinore mendoj se është një raport shumë bosh, shumë i shkurtër, nuk ka diçka të veçantë thuhetse kjo zyre nuk ka punuar aspak, ne të gjithë e dimë qëllimin e kësaj zyre, e dimë se barazia gjinore vlen për tu dëshiruar, ne në kohën e fundit kemi pasur rast që të ballafaqohemi me zgjedhjen e këshillave të lokal dhe këshillave të fshatrave, ku kriteri ka qenë që me marr pjesë edhe gjinia femërore, ne të gjithë e dimë se sa ka qenë ajo pjesëmarrje, mendoj se kjo zyre duhet të jep kontributin në çdo aspekt, përmendet këtu edhe procesi i riatdhimit, kisha dashur ta di a është kjo zyre adekuate për këtë apo jo. Sa i përket raportit të punës së Drejtorisë së Shëndetësisë, mendoj se është një raport i cili ka përfshirë pjesën më të madhe të asaj që është punuar, kisha ndërhyrë tek ndërtimi i objektit të QKMF-së, ne paraprakisht kemi pasur disa vërejtje edhe si kuvendar por edhe si drejtori, ku i kemi prezantuar disa mangësi teknike që i ka ky objekt. Është formuar një komision ku kemi dalë pastaj në teren ku kemi konstatuar se në këtë objekt duhet të bëhen disa ndryshime, pastaj duhet të merren parasysh të gjitha ato në mënyrë që mos të kryhet objekti pa u bërë ato punë, sepse më vonë do të kemi pasoja të pariparueshme. E kam përmendur shumë shpesh sistemin e informimit të shëndetësisë forma digjitale është ndërprerë në QKMF dhe asgjë deri më tani nuk është ndërmarrë në këtë drejtim, mendoj se duhet që të punohet në këtë drejtim dhe të aktivizohet forma digjitale e punës sepse e ardhmja është forma e sistemit digjital, e mos të flasim se ky sistem grumbullon edhe të hyrat buxhetore nga participimi në fushën e shëndetësisë. Komisioni shëndetësor për dhënien e certifikatave për patentë shofer Rahoveci nuk e ka, vijnë qytetarët pyesin dhe ne duhet që të i kthejmë, duhet që ti themi se komuna jonë nuk ka dhe duhet të shkoni në komuna të tjera, është diçka që ne as nuk e kryejmë shërbimin atyre, por as nuk krijojmë të hyra për komunën tonë. Në këtë raport nuk kam parë asgjë sa i përket raportit të dializës, është dashur të ceket ndonjë fjalë sa i përket këtij reparti, nëse ka qenë për detyrë diçka me u realizua, nuk është asgjë e keqe të thuhet se nuk kemi mundur për këtë arsye. AMF-ja në Brestoc pjesën më të madhe të vitit nuk ka funksionuar, arsyen e di pse nuk ka funksionuar, por duhet të ceket se në fillim ka punuar, kurse tani nuk është funksionale, arsyeja është sepse ka mungesë të mjekëve. Koncepti i mjekësisë familjare është një koncepte pas të cilit duhet të formohet edhe programi por edhe strategjia e kujdesit parësor shëndetësor të cilit ne i takojmë, kurse këtu unë asnjë fjali nuk jam duke e parë, drejtoria duhet që të ketë strategjinë e konceptit të mjekësisë familjare, është duke u punuar diçka rreth kësaj por si duke ne jemi diku në mes, sepse duhet të ketë më shumë mjekë, specialistë të mjekësisë familjare sepse ata lidhen për institucione. Sa i përket Drejtorisë së DKA-së ka gjëra pozitive, do e cek si pozitive çështjen e bursave për student që është dhënë pas tre viteve, ne jemi pro asaj që bursat të ndahen çdo vite, po ashtu ne si kuvendarë jemi të interesuar që bursat të i marrin ata studentë që i meritojnë. Do të ishte mirë që kuvendi të ketë qasje në ndarje të bursave për studentë. Tek Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, i nderuari z. Masar Popaj i kërkoi disa sqarime, këtu përmendet gjithashtu edhe rruga transit që është mbi Rahovecit, e di se është duke u punuar në këtë rrugë, por e kam një propozim, ti nderuar Rahoveci si qytet ka mungesë të shtigjeve të ecjes, prandaj nëse ka mundësi aty që të ndërtohet një shteg për ecje, ai vend është shumë i përshtatshëm sepse pozita është e tillë që do i konvenonte të gjithëve. Kalojmë tek Drejtoria për Bujqësi, sa i përket pagesave direkte sa e di unë ende ka nga bujqit që

nuk i kanë marrë, nëse kjo është e vërtetë atëherë Komuna duhet që të angazhohet që këto pagesa të kryhen, ne e dimë se këto pagesa i kryen Qeveria e Republikës së Kosovës, por komuna duhet të luaj rolin e vetë. Gjithashtu në këtë faqe ceket edhe dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet dhe breshëri vitin e kaluar, ne rreth kësaj kemi debatuar disa herë, janë formuar komisionet ku e kanë bërë një vlerësim ku sipas tyre dëmet kanë qenë deri në 5 milion, ne nuk kemi informatë nëse është bërë diçka në këtë drejtim. Në faqe nr.31 i keni cekur po ashtu subvencione me hektar tek të gjitha këto resorë si vreshtari, grurë, misri etj. mendoj se kishte me qenë më mirë sikurse në tabelë të figuronte edhe çmimi për hektar dhe shuma e përgjithshme se sa janë subvencionuar bujqit nga Komuna e Rahovecit për vitin 2018. E përshëndesim iniciativën që e ka mare Kryetari i Komunës për zbritje të përqindje së participimit për sera nga 25% në 20% nga bujku dhe 80% nga komuna, mirë është që bujqit tanë të kenë sa më shumë sera, sepse ato krijojnë edhe vende të punës por edhe risin prodhimin vendor, prandaj ne e përkrahim plotësisht. Në një vend ceket menaxhimi i vendgjahishtës Dafina, ku llogaritet ndër më të vështirat, po ashtu konsiderohet si sfidë e vitit, nuk e di se çka qenka kjo që është aq e rëndësishme. Sa i përket DKRS-së, kjo drejtori e ka prezantuar një raportë shumë të shkurtër, sipas këtij raporti shumë pak qenka punuar, jemi duke parë që në 4-5 vende ceket vetëm Flaka e Janarit, nuk përmendet asgjë rreth trashëgimisë kulturore dhe historike, Rahoveci si qytet por edhe nëpër fshatrat ka objekte të rëndësishme kulturore historike, janë disa shtëpi të vjetra të kohës së mesjetës, të cilët duhet të hynë në kuadër të këtij resori dhe nën mbrojtje të komunës. Aspekti i kulturës muzikore dhe artistike të i jepe rëndësi komuna të i ndihmojë, po ashtu shkollës së muzikës Rahoveci duhet të i ndihmojë, sepse grupet amatore mendoj se do të kishin mundur përmes shkollës me u zhvillu, në mënyrë që, komunës tonë të i jepet një gjallëri kulturore dhe artistike më të madhe dhe në këtë mënyrë ritet edhe kualiteti i jetës.

Rasim Fazliu – Fillimisht e falënderoj Kryetarin e Komunës që na ka sjellë Raportin e Punës për vitin 2018, para se të ja filloj të diskutoj rreth këtij raporti, do filloj së pari menjë thënie: Një letër këmbim që kanë pasur dy miq shkrimtar në mes vete, njëri ju ka drejtuar atij tjetri me letër: I nderuar në mungesë të kohës që e kam po ti shkruaj 15 faqe, por të kisha pasur kohë më tepër do të kisha shkruar një faqe e gjysmë. Me këtë dua të them se raporti është mjaftë voluminoz, e tregon punën e qeverisë për vitin 2018, por ka edhe gjëra që janë shumë të përgjithësuara dhe nuk kanë pasur fare nevojë këtu të jenë të përfshirë, po ashtu mungojnë disa detaje që i ceken edhe kolegët e mijë, por po ashtu edhe unë disa do i ceki. Po ja filloj nga aty ku i keni cekur aktivitetet e rëndësishme, aty ceket se elaborati i përgatitur dhe adresimi për shpronësimin e pronave private për nevojat e rrugës së transitit në Rahovec, këtu mendoj se është dashur të ceket se sa prona private janë shpronësuar, kështu do të ishte ma e kuptueshme për ne. Pastaj dua të ndalem aty ku thotë se përqendrimi i presionit për qartësimin e projektit të palestrës së sporteve në qytet dhe tejkalimin e vonësve të gjatë rreth saj. Sa e di kontrata ka qenë e përmbyllur në fund të vitit 2018, kurse ende punimet nuk janë kryer, mendoj se është dashur të ceket pse nuk janë përfunduar punimet në palestër. Pastaj sa i përket Raportit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ne jemi informuar se është formuar Komiteti i Auditimit, kurse në raportin e kryetarit nuk kemi kurrfarë të dhëna sa i përket punës së Komitetit të Auditimit. Po ashtu shpresoj se në vitin që sapo kemi hyrë, Kryetari i Komunës do të na informojë gjatë vitit për punën e njesisë së auditimit të brendshëm, sikurse që na ka informuar në vitin paraprak. Në faqe nr. 19 ceket se janë adresuar disa kërkesa për riparime të disa shkollave Ministrisë së Arsimit, mendoj se është dashur të ceken se sa kërkesa janë pranuar nga ministria, pasta në cilat shkolla janë bërë meremetimet, në mënyrë që ne të kemi pak më të qartë. Përveç gjërave pozitive që i keni cekur në DKA, mendoj se është dashur të jetë raporti më i plotësuar rreth kësaj sepse vetëm një gjysmë vjetor ka përfunduar, është dashur të ketë një pasqyrë si suksesi i nxënësve, pastaj sfidat, arritjet pozitive dhe negative, nga të gjitha nivelet duke filluar nga klasat para fillore e deri tek klasat e mesme, dhe me siguri do ta plotësonte më mirë këtë raport të kryetarit. Do të ndalesha pak edhe tek raporti i zyrës për informacione turistike, ku ceket se janë bërë pritjet dhe informim i të gjitha turistëve që e kanë vizituar komunën tonë, mendoj se edhe këtu është dashur të ceket një shifër se sa turistë e kanë vizituar komunën tonë. Tek Drejtorja e Urbanizmit dhe Planifikimit të

Mjedisit ceket se disa kërkesa tona janë të përfshirë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2019, mendoj se më së miri kishte me qenë nëse kishit me thënë se kemi bërë kërkesa dhe pastaj të cekni se cilat kërkesa janë plotësuar. Tek Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, ceket se janë bërë përgatitjet e aktvendimet për uzurpimet arbitrare, mendoj se këtu është dashur të ceket se sa prona kanë qenë të uzurpuara në Komunën tonë, dhe çka u ndërmarrë rreth tyre, e jo të ceket në mënyrë të përgjithshme. E kamë ngritë edhe më herët një shqetësim sa i përket rrugës e cila është duke u ndërtuar nga Ministria e Infrastrukturës Krushe e Madhe – Randobrav, më ka shqetësuar fakti pse nuk ka filluar ndërtimi i rrugës në fillimi i rrugës kryesore nga Krusha e Madhe tek varrezat, dhe të vazhdoj, kurse tani punimet ja kanë filluar nga mesi, ka pasur edhe disa vërejtje të qytetarëve për arsye të plasaritjeve të mureve. Kryetar i nderuar në këtë raport rreth sektorit të menaxhimit të mbeturinave nuk e kamë parë asnjë fjalë, ne e dimë se qysh në vitin 2016 është dashur të punohet, kurse ne tani jemi në vitin 2019 dhe asgjë në këtë drejtim nuk është bërë. I nderuar Kryetar kur do të formohet sektori për menaxhimin e mbeturinave, çfarë hapa do të ndërmerren, si do të bëhet, kur do të kalojë kjo në kompetencat e komunës, në mënyrë që komuna të filloj implementimin e pagesës, dhe kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në të hyrat e komunës. Pastaj në përgjithësi do e them se nëpër drejtori është paraqitur shumë pak aspekti financiar, si të hyrat ose investimet kapitale, pak a shumë mundemi të themi se Raporti i punës së Kryetarit për vitin 2018 është i zhveshur nga raporti financiar, meqenëse kryetari është përgjegjës kryesor për financat e komunës së Rahovecit. Pastaj nuk e keni cekur në Raport se çka ka ndodhur me kompensimin e dëmeve që janë shkaktuar gjatë vërshimeve dhe gjatë breshëritë që kanë rënë në Komunën tonë, kur e dimë se në shumë komuna të tjera kanë ndodhur edhe më vonë se në komunën tonë, kurse ne kemi informacione se atyre ju janë kompensuar.

Kryetari – Jam dakord me z. Sali Sallteku që edhe drejtorët të japin përgjigje rreth disa shqetësimeve, unë do të përgjigjem pjesës thelbësore e cila lidhet me raportin. I nderuar z. Rasim fazliu, ne i marrim raportet nga njësitë e caktuara dhe sektorët të caktuar etj. krejt çka kemi bërë ne është se jemi munduar që të artikulojmë, që ti evidentojmë çështjet thelbësore të cilat i ka disponuar ai raporte që i ka sjellë në zyrën e Kryetarit të Komunës, nëse do të isha pyetur unë ndoshta do ta kisha bërë komplet ndryshe, por po ashtu pajtohem që duhet të ketë një standard të raportimit, pastaj duhet të ketë një harmonizim midis asaj çka kërkohet dhe asaj çka shkruhet. E para të nderuar ne raportin e punës e kemi veçuar nga raporti financiar, për pjesën financiare, tabelara besoj se Drejtoria e Financave në Raportin financiar që e kemi pas kësaj pike do të ketë më shumë fakte dhe argumente për të ju prezantuar për të gjitha ato që ka ndodhur gjatë vitit 2018. Barazimi nuk ka përfunduar sepse besoj se deri me 31.01.2018, Ministria e Financave do ti bëjë ato barazime dhe harmonizime që i kanë si ministri, dhe harmonizimi dhe barazimi në mes komunës dhe MF nuk bëhet tani por pas datës 15 janar të vitit të ardhshëm, prandaj edhe pasqyrat financiare të sakta ne mundemi të dimë tek në muajin shkurtë. Raporti mundet të jetë më i shkurtër e thatë, pajtohem me ju, por paramendoni se raporti ka qenë më shumë se 120 faqe, ne pastaj kemi hyrë ku e kemi shfletuar dhe kemi arritur që të vijmë deri tek ky raporte që e keni ju para vete, si pasojë e kësaj jam duke parë që ka ndonjë e metë, sikurse tek Drejtoria e Kulturës e cila paska mbetur tek Flaka e janarit, kurse plotë aktivitetet të tjera janë zhvilluar në këtë drejtori edhe pas flakës së janarit gjatë gjithë vitit. Por ta dini se raportet e detajuara nga secila drejtori, po ashtu edhe nga zyra për barazi gjinore ekzistojnë tek sirtari i Kryetarit të Komunës, me të gjitha të dhënat. Raporti është e vërtet që përmban të arriturat dhe sfidat, pastaj secila qeveri që vije është normale që nuk i futë ato të cilat nuk janë realizuar, ne e dimë që ka plotë teme që nuk janë kryer, por ju sugjeroj që të shihni planin e punës për vitin 2018 dhe aty pastaj të bëni krahasime, çka është realizuar dhe çka nuk është realizuar, por mos harroni se ka plotë gjëra që nuk janë parashikuar në atë plan por janë realizuar gjatë viti 2018. Do ju japë pak informatë për transitin, ky transite është gati, ne është dashur të bëjmë një elaburim të shpronësimeve dhe të shohim se sa pronarë janë shpronësuar, dhe ky shpronësim kryhet nga Departamenti i veçantë i shpronësimit i cili është në kuadër të Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë dhe të Mjedisit, rruga është zhbllokuar dhe shpresojmë se shumë shpejtë të asfaltohet. Kërkesa e

imja në emër të tuajin do të jetë që kjo rrugë të futet si rrugë e ministrisë, zyrtarisht të jetë rrugë rajonale e Ministrisë së Infrastrukturës në mënyrë që edhe kujdesi të ritet por të ketë edhe elemente shoqëruese si rrugë, pastaj sinjalizimin ta ketë më të mirë, mirëmbajtjen më të mirë, pastaj të ketë shtegun për biçikletë, këmbësorë. Rruga Krushë e Madhe – Qendresë ish Randobravë, është në projekt i mirë i kushtueshëm, por që edhe ky projekt është duke u financuar nga Ministria e Infrastrukturës, ne shpresojmë se nëse e gjejmë ndonjë mekanizëm ta lidhim edhe me rrugën tek varrezat e Krushë së Madhe, sepse zgjidhja e cila është dhënë në atë kohë ka pasur kosto të lartë. Sa i përket sektorit për menaxhim të mbeturinave ne që nga muaji mars kemi filluar që të mëremi me këtë temë, por implementimi i shumës prej 400,000.00 € që e kemi është shumë e vështirë e realizueshme, përveç Prizreni që ka filluar edhe pse edhe ata e kanë shumë vështirë, ndërsa asnjë komunë në Republikën e Kosovës nuk ja ka filluar. Ne kemi biseduar me Eko-Regionin që inkasantët e tyre ta bëjnë këtë punë dhe të hyrat të i mbesin Komunës së Rahovecit, por me këtë nuk kemi mundur të bëjmë ndonjë zgjidhje. Do të shohim se çka mundemi këtë vit me bë sepse këtë vit shumë më pak mjete janë paraparë. Tek aktvendimet për uzurpime arbitrare, jam i bindur që secili aktvendim i cili ka të bëjë me prona gjendet në ambientet e komunës për gjithçka që kemi kërkuar ne, ne tani kemi kërkuar që të pezullohet aktiviteti për likuidimin e Oltit, ne mundohemi nëse me e ndërpre këtë proces që mos shkojë më tutje, sepse ne ndoshta dëshirojmë që në atë vend të ndërtojmë ndonjë treg të madh për pemë dhe perime. Ju siç e dini pronat e AKP-së tani për tani janë të pezulluara sepse Presidenti i vendit ka bërë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe nëse janë mare prona nga AKP-ja nga komunat e caktuara tani për momentin janë pezull deri sa të vije një përgjigje nga Gjykata Kushtetuese. Sa i përket Drejtorisë së DKA-së ndoshta nuk i kemi futur në raport shumë statistika, por ju siç e dini ky kuvend e ka një praktik që çdo vit të kate një pikë në kuvend sa i përket DKA-së, pra një informatë rreth DKA-së, aty përshihen ecurit e një vjetori, pastaj sa janë mungesat e nxënësve etj. Arsyeja pse nuk i kemi përfshi të gjitha është sepse Raporti vjetor i Kryetarit përmban, aktivitetet kryesore që e karakterizojnë komunën tonë për një vit. Sa i përket palestrës së sporteve, është e vërtet që ne shumë shpesh jemi ngutur dhe kemi caktuar data për përfundim të palestrës, është e vërtet se ndonjëherë ka pasur paqartësi dhe keqkuptime, po ashtu është e vërtet që ne tani jemi autoriteti kontraktues, por financimin e bënë Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve. Vështiruesit për realizimin e kësaj kontrate kanë qenë evidente, ndoshta më lehtë kishte me qenë që të ishte ndërtuar nga fillimi se sa të vazhdohet aty ku ka mbetur, prandaj këto vështirësi besoj se nuk i atribuohen Komunës së Rahovecit, dhe asnjë qeverisje që ka qenë deri më tani, por i atribuohen Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sporteve. Besoj se palestra do të kryhet në muajin shkurtë, ku dhe do të organizohet finalja e 8 e Super Kupës së Kosovës, ku për herë të parë është duke u organizuar në qytetin e Rahovecit. Të nderuar sa i përket Komitetit të Auditimit të Brendshëm ndoshta është, dashur të jetë në raport, por sa e di unë ka qenë një rekomandim i zyrës kombëtare, ku i kam kërkuar pastaj kolegëve të mi që nuk guxon edhe një herë të dele që nuk funksionon Komiteti i Auditimit të Brendshëm, e di që janë mbajtur disa takime dhe ky komitet tani e tutje është funksional. Ndoshta është dashur të ceket në këtë raport, e keni të drejtë, por besoni se ka qenë shumë vështirë të dihet se çka është dashur të futet në raporte e çka jo sepse ka pas material voluminoz, por kjo le të jetë vërejtje për herën tjetër. Tek kompensimi i dëmeve, ne kemi insistuar dhe vazhdojmë që të insistojmë në respektim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili është nënshkruar nga Kryeministri z. Ramush Haradinaj. Është e vërtet po ashtu se Suhareka ka mare një grand, por duhet të dini që nuk e ka fituar në bujqësi, por e ka mare për vërshimet që kanë ndodhur në infrastrukturë, prandaj jam i bindur se kompensimi i dëmeve që ka ndodhur në bujqësi në komunën tonë do të kompensohet shumë shpejtë, dëmet kanë qenë në vlerë mbi 5 milion, kurse cila do të jetë shkalla e realizimit të kompensimit për atë nuk vendosim ne, por synimi ynë është që të kompensohen 100%. Sa i përket zyrës së prokurimit i nderuari z. Cena ne e presim një raport të na vije për të gjitha kontratat që i ka zyra e prokurimit dhe besoj se ai raport do të publikohet në veb faqe. Tek bursat për studentë, ne i kemi shqyrtuar aplikacionet të cilat i kemi pranuar si trashëgimi kur e kemi mare mandatin, aplikimi është bërë në vitin 2017 kurse vendimi për

ekzekutim të bursave nuk është bërë në vitin 2017, por në vitin 2018, ne nuk kemi pranuar aplikacione të tjera vetëm ato që kanë qenë, nga 88 aplikant që kanë konkurruar 63 prej tyre i kanë fituar bursat. Kriteret kanë qenë ato që i përmendet ju pak më parë, ne do të vazhdojmë me ndarje të bursave, këtë vite do të hapet përsëri konkursi dhe ne synojmë të risim numrin e bursistëve. Tek lumi Rimmnik në Fortesë do të ketë përsëri aktivitete sa e di unë, pastaj hapësirat e gjelbëruara janë një pozicion i rëndësishëm dhe një prioritet i madhe për komunën tonë, ne kemi mbledhë druaj dekorativ në Fortesë dhe në shumë fshatra të tjerë, ne vazhdojmë edhe tani me mbjellje të drunjëve dekorativ, prandaj mirëmbajtja dhe krijimi i hapësirave të reja gjelbëruese do të jetë një pozicion i rëndësishëm ku do të reflektohet puna jonë edhe në të ardhmen. Tek pyetja se sa kërkesa ne ja kemi drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe sa prej tyre na janë miratuar,, ne si komunë ja kemi bërë një mal kërkesash, disa nga këto kërkesa janë miratuar, njëra nga ta është edhe rritja e punëtorëve në Drejtorin e Shëndetësisë, pastaj themelimi i zonës industriale ekonomike rrugës për Suharekë, pastaj marrja e pronës 7 hektarësh në shfrytëzim të përhershëm nga Komuna e Rahovecit tek Epopeja e UÇK-së, ku pritet të ndërtohet stadiumi i ri i kategorisë së dytë. Pastaj e kemi filluar të drejtën që këtë vit që të ndërtojmë rrugën katër kursi nga Rahoveci për në Xërxë, pastaj rrugën Rahovec- Hamovc – Fortesë, pastaj rruga Ratkoc – Xërxë – Sopniq, pastaj shtegu i ecjes për tek maja e Shkodranit, pastaj e kemi fituar të drejtën për ndërtimin e kompleksit muzeor Ukshin Hoti, ku kemi fituar mjete, pra kemi hapur kod edhe në ministri por edhe në komunë. Pra janë disa prioritete të Komunës së Rahovecit që janë duke u mbështetur dhe që synojmë të mbështeten edhe disa prioritete dhe kërkesa të tjera nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës , dikush mundet të pyes se a janë të mjaftueshme, mendoj se asnjëherë nuk janë të mjaftueshme, por ne jemi duke punuar që të kemi më shumë mbështetje nga ana e Qeverisë së Kosovës. Ne e kemi hapur një grand për vitin 2017 për shkak të raportit jo të mirë të auditorit të jashtëm ky grand ka qenë nga Demosi, pastaj një grand tjetër që kemi shpresuar se e kemi fituar dhe mendoj se për këtë na kanë bërë të padrejtë është grand i për mbeturina, ne kemi qenë komuna e pestë, por ka ndërhyrje në këto muhabete si duket dhe na kanë bërë të padrejtë neve dhe disa komunave të tjera, arsyen nuk e dimë as ne. Përndryshe ambienti në Komunën e Rahovecit është më i pastër në vitin 2018, po ashtu do të jetë edhe më i pastër në vitet e ardhshme. Raportin ne e pranojmë me këto vërejtje dhe sugjerime që janë dhënë nga ana e juaj, ne marrim obligim që ta standardizojmë me të vërtet mënyrën e raportimit.

Dervish Çadraku – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, me të vërtetë materiali për këtë mbledhje është shumë voluminoz, ne në KPF e kemi pas edhe si vërejtje sa i përket mos ardhjes së materialit me kohë. Ju vetë e thatë se keni herë këtë material ku e keni lënë pjesën më substanciale, por megjithatë përsëri është shumë, kam një propozim: Kur kemi të bëjmë me këso materiale kishte me qenë mirë që të kemi pika të rendit të ditës më pak, sepse ne sot nuk mundemi të kemi një debat të frytshëm sepse kemi shumë pika të rendit të ditës, po ashtu kisha me propozu që materiali i Raportit Vjetor të Punës së Kryetarit për vitin 2018 dhe Plani i Kryetarit për vitin 2019 të hynë në një pikë të rendit të ditës, pastaj ne i kemi materialin se çka është punuar dhe tjetrin se çka keni ndërmend të punoni, me këtë do na dele një materie që është shumë më e kapshme dhe shumë më e pranueshme për të gjithë ne. Unë për vete e kam bërë kështu dhe e kam ndërmend të diskutoj për të dy këto pika, sepse kur i kam krahasuar më ka dalë një poemë shumë e bukur me prirje artistike poetike. Nëse e marrim krahasimin e punëve në teren nuk është se nuk keni punuar, por detyra e gjithë neve këtu është që të luajmë rolin e sitjes dhe të shikojmë se çka nuk keni punuar dhe çka është dashur të punohet, ju edhe vetë ishit të sigurtë kur e thatë se ne nuk i fusim në raporte disa gjëra që nuk na pëlqejnë, kjo besoj se është normale. Po ja filloj me Zyrën e Personelit, komuna jonë i ka 162 punëtor dhe nga ky numër asnjë nuk është me aftësi të kufizuar, komuna jonë ka një numër të madh me aftësi të kufizuar, prandaj mendoj se kishte me qenë mirë që kjo kategori të merret parasysht, pastaj e kemi thënë edhe më parë që kjo kategori duhet që të ketë qasje më lehtë në zyrat e komunës, duke filluar nga lifti, e kam parë që nuk e keni bërë por as që keni objektiv me e bërë. Kurse nëse dalim në Drejtorin e Administratës, administrata nuk është ndonjë kualitet i ri dhe më i fuqishëm ose më ekspeditiv, ne e kemi

me pamundësi qasje me makina në oborrin e komunës, nuk kam parë diçka që do ta tejkalonte këtë problem, kam propozuar më parë që tek ish shkolla e mesme të ndërtohet një garazh ku do ti parkoni makinat të gjithë punonjësit publik, si të komunës, policisë, gjykatës etj. Ju e keni bërë shumë zhurmë punën e parkingut për katër makina për ata që vinë nga diaspora, mendoj se ajo ka qenë një reklamë e mirë, por jo një zgjidhje. Sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike e kisha lidhë me Drejtorin e Urbanizimit dhe Zhvillim të Mjedisit, ne kemi probleme me parkingje, pastaj kemi probleme, me trotuare, kemi probleme me kanalizime, komuna ende ndërton kanalizime pa hapjen e gropave septike, cili është roli i inspektorëve këtu. Mendoj se inspektorati së pari juve duhet të ju bëjnë një proces të kallëzimit penal sepse ju ende bëni kanalizime pa grupa septike, kurse nëse një qytetar e bënë këtë ju e dënioni. Kalojmë tek DKA-ja, nuk po them se ka ngecur me punë, por kur vijnë menaxherit e rijnë besoj se duhet tregojnë diçka më të veçantë, ne ende sot kemi mungesa të mëdha në arsim sa i takon infrastrukturës së brendshme, ose mjeteve konkretizuese, ne në shkolla nuk kemi as kabinete po as liberatore, edhe nëse kanë ndonjë shkollë sallë sportive aktivitete nuk kanë, unë që 40 vite e kam kryer shkollën e mbaj mend se atëherë ka pasur aktivitete sportive sa të duash. Këto mjete konkretizuese janë të domosdoshme, prandaj ne sot ankohemi se nuk kemi një arsim të mirë për nxënës, pastaj nuk kemi interesim shumë të nxënësve, nxënësit e zënë si humbje kohe ose maltretim që të shkon në shkollë, pra nuk janë atraktive ambientet e shkollave për ta. Ne jemi dëshmitar të kësaj sepse na ka qitë edhe Pisa shumë keq, sado që disa duan që të arsyetohen se kanë qenë disa faktor tjerë që kanë ndikuar, më parë në arsim ka pasur edhe grupe letrare, muzikore, kurse sot e kemi këtë mungesë. Anomali më e madhe është që ne sot ende nuk mundemi me e lidhë nxënësin me librin, nuk mundemi me stimulua që të i japim një lloj vullneti që nxënësi të merret me libër, aq më keq ne nuk kemi as libra në shkolla, kjo duhet të përmirësohet dhe të mbushen shkollat me libra si literaturë e lirë. Do të dalim tek Drejtoria e Shëndetësisë, është duke u ndërtuar një objekt i madh i cili është i mirëseardhur, është objekt për të cilin ka nevojë komuna jonë, por i nderuar kryetar sot të shkoni ju për të bërë analiza do të shihni se nuk ka as analiza elementare, pastaj as barnat bazike elementare nuk kanë, prandaj mendoj se është më mirë që ta furnizoni QKMF-në me këso materiale sepse qytetari ka nevojë emergjente për këto gjëra. Sa i përket bujqësisë me të vërtet shumë është fole, posaçërisht evidentimi i atyre se sa kemi humbur gjatë reshjeve dhe vërshimeve që patën ndodhur në komunën tonë, por nuk është lëvizur asgjë në kuptimin e kompensimit. E kam vërejtje sa i përket asaj që jeni duke i thirrur të gjitha proçkat lumenj, ne kemi vetëm një lumë ai është Drini Bardh, tjerat janë proçka, këto proçka të nderuar do të na qesin nga fshatrat tona dhe tokat tona sepse ende nuk po kemi mundësi që ti rregullojmë ato, prandaj është detyrë e komunës që sa më shpejtë këto të i rregulloj sepse ne të ardhurat kryesore i kemi nga bujqësia. Kalojmë tek Drejtoria e Kulturës dhe Sportit, nuk e di se çka kemi të bisedojmë rreth saj, shumë pak është punuar deri më sot, më herët kanë qenë rreth 8 biblioteka me 40-50 mijë banorë, kurse sot janë rreth 60-70 banorë në Komunën e Rahovecit kurse kemi 1 bibliotekë e gjysmë, me shumë pak ekzemplar dhe shumë të mangët sa i takon titujve, mendoj se duhet të mendohet në këtë drejtim se çka mundë të bëhet. Pastaj aktivitetet rinore janë shumë të dobëta, më parë kanë qenë disa fusha sportive të cilat tani nuk janë funksionale, pyetje ime është pse është duke ndodhur kjo, mos duhet të ketë më shumë stimulim nga komuna që ato të aktivizohen. Kur e kemi fjalën për Drejtorin e Inspektoratit, detyra e tij është që të dele në teren sa ma shumë që është e mundur, por si ka mundësi të nderuar që mbi 30 deponi i keni pastruar kurse inspektorët nuk e kanë dënuar asnjë palë, ose nëse kanë dënuar kanë dënuar shumë pak. Mënojt se nëse dënohen ata që kanë gjuajtur mbeturina më nuk do të gjuajnë, ne më shumë shpenzojmë që ta pastrojmë një deponi me mbeturina, se sa të caktojmë një deponi të përbashkët dhe pastaj inspektorati të mbajë kontrollin, unë e di që ky inspektorat as nuk bënë dënime të mjaftueshme për mbeturinat, as për zhavorrin, as për pirje të duhanit, as për ndërtimet pa leje dhe as për ndotje akustike. Mendoj se duhet të ketë një dinamik më të madhe dhe më të fuqishme sa i takon këtij mekanizmi, për punën që qytetarët të janë më komod me jetën e tyre të përditshme. Kalojmë tek Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, vjelja e taksave nga kjo drejtori në vitin 2017 ka qenë 65,000.00 €, kurse në vitin 2018 është

106,000.00 €, e di se 2017 ka qenë fundi i mandatit dhe nuk kanë pasur kohë të dalin dhe të i mbledhin këto taksa, taksat e grumbulluara në vitin 2018, nuk janë pak, por ne kemi edhe plotë taksa të tjera që janë të pa grumbulluara, duhet të gjendet mekanizmi për tu vjelë këto taksa, sepse ka shumë njerëz të pa përgjegjshëm dhe ata munden të presin që nesër ju të i falni ata, por pyetje është çka të bëjmë me ata njerëz të ndërgjegjshëm të cilët kanë paguar rregullisht dhe e kanë mbajtur komunën me të hyrat e tyre. Besoj se këto janë disa nga vërejtjet e mija të cilat i bëra krahasimet e mandatit të kaluar me këtë mandat, ku ne duhet ta gjejmë një baraspeshë e cila do të ishte shumë produktive qytetarët e komunës sonë.

Sali Sallteku - Tek DKA-ja është bërë një gabim teknik besoj, sepse tek udhëtimi i nxënësve Guri Kuq – Kramovik, sa e di unë bëhet Rakovinë – Kramovik, pastajaa e ka bërë edhe për udhëtimin Retij e Ulët – Priranë. Mendoj se është gabim kjo është dashur të paguhet transporti për Retij e Naltë e jo të shkojnë për Piranë, sepse kjo i bie që shkojnë në një komunë tjetër. Kemi rastin edhe me Komunën e Gjakovës, ajo nuk ka dashur që ti paguaj nxënësit që kanë ardhur nga Rakovina në Kramovik sepse ka thënë se ti je duke i mare mjetet. Sa i përket Raportit të Punës së Kryetarit, ky raport nuk votohet fare dhe kryetari gjatë punës mundet të shoh ndonjë gabim, po ashtu mundet të shtoj diçka, prandaj mirë është kështu siç është, kjo është punë e kryetarit ne mundemi të bisedojmë por ai përsëri vazhdon ashtu siç dëshiron vetë.

Dervish Çadraku – I nderuari Kryetar bursat për student janë në kompetencat e juaja më duket, me herët ka qenë kompetencë e një komisioni i formuar nga kuvendi komunal, mendoj se kishte me qenë mirë që ky komision të zgjidhet nga komisioni komunal për vlerësim të bursave.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë, të nderuar Rregullorja për Subvencione është bërë në vitin 2016 e cila është sponsorizuar nga Demos Zvicëran, më herët ka qenë që komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve nga studentë të bëhet nga kuvendi dhe ekzekutivi i komunës, Demosi atëherë ka këmbëngulë që të largohet kjo praktikë dhe të jenë vetëm shërbyesit civil dhe një nga shoqëria civile.

Kryetari – Është e vërtet që është debatuar shumë rreth Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës, shumë çka mundet të planifikohet por edhe shumë çka nuk mundet të planifikohet shpejtë, ashensori është e vërtet se i mungon këtij objekti, por edhe ata të cilët e kanë ndërtuar këtë objekt nuk e di se si nuk e kanë mare parasysh faktin për njerëz me nevoja të veçanta dhe ata duhet të kenë qasje në objekt, përveç atyre besoni se edhe unë kam problem me dalë sepse palët të presin në korridore. Vendi për ashensorë është në objekt por asnjëherë nuk është qitë ashensori dhe kjo është gabim. Përndryshe për njerëz me aftësi të veçantë është prioritet të cilin duhet ta kemi edhe ne por edhe ju të gjithë së bashku, sepse ka ngarkesë edhe nga organizatat e huaja, por është nevojë imediate edhe e jona si komunë. Tek aktivitetet e kulturës, rinis dhe sportit, është e vërtet që ne kemi disa terrene sportive, ne si komunë i kemi mbështetur me ato subvencione që i kemi pasur, këtë herë i kemi mbështetur më shumë se çdo herë tjetër sportet, kulturën dhe rininë në Komunën e Rahovecit, në një mbledhje tjetër do ju tregoj se sa janë shumat për klubet sportive, pastaj për shoqëritë kulturore artistike dhe sa aktivitete kulturore sportive në përgjithësi janë mbështetur gjatë vitit 2018. Mundet të jetë e vërtet që sallat e edukatës fizike janë boshë, por ne i kemi organizuar turnire, por e di që nuk janë të mjaftueshme. Ne e kemi rritur fondin për kulturë rini dhe sport, kemi bërë disa aktivitete që besoj se do të vazhdojnë të bëhen edhe tjera në këtë vit, përveç atyre që janë profesionale. Z. Dervish Çadrakun e respektoj shumë dhe shumë shpesh i kam thënë se nuk je për anëtar të kuvendit, por je për një vend pak më special, sepse ka trajtuar tema që janë në përgjegjësinë tonë, por duhet të dini se nuk jemi vendimmarrësit e vetëm në këtë proces, por janë edhe shumë faktor të tjera duke filluar nga institucionet qendrore, institucioneve lokale etj. ne nuk e kemi fshehur faktin që kemi probleme me ujërat e zeza, pastaj me kolektor të ujërave të zeza, me impiante të ujërave të zeza etj. Ju keni hapur plotë teme të cilat ndoshta i takojnë edhe ndonjë tryeze shkencore sepse keni prekur teme të cilat nuk i kemi ne sot ose nesër si institucione me i dhënë zgjidhje ne dhe vetëm ne, sepse ndërlidhen me shumë faktor të tjerë që e kanë peshën dhe rolin e vetë në këto procese. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë gjatë debatit për Raportin Vjetor të Punës së Kryetarit për vitin 2018.

Kryesuesi – E falënderoj Kryetarin që i dha përgjigjet rreth pyetjeve të kuvendarëve rreth Raportit të Punës së Kryetarit për vitin 2018. Po ashtu ju falënderoj juve kuvendar për debatin e mirëfilltë që e keni zhvilluar. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Informatës mbi Planin e punës të Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ky është një Plan i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale, në fillim të planit është zotimi i Kryetarit në fillim të mandatit, pastaj janë të paraqitura synimet për vitin 2019, prioritetet kryesore. Ku trajtohen pastaj njësitë në kuadër të zyrës së Kryetarit, pastaj janë të cekura të gjitha punët që janë kryer në kuadër të zyrës së Kryetarit. Pastaj janë të synuara synimet dhe prioritetet për çdo drejtori, gjithashtu janë të paraqitura sektorët në kuadër të të gjitha drejtorive për punët e veta. Nuk dua të zgjas më shumë, informatën e keni para vete dhe fjalën tani e keni ju.

Fahrije Lushi Morina – Do të ndërlidhesha menjëherë tek Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, më pëlqejnë disa projekte dhe prioritate që janë vendosur si temë në vete, organizimi dhe ngjarje kulturore, takime letrare, prezantime, shpërndarje librash, ekspozita arti etj. Po ashtu është edhe nxitja e lejueshmërisë dhe hapja e bibliotekave nëpër lokalitete dhe shkolla të komunës, furnizimi me libra i bibliotekave komunale dhe hulumtimi i dhuruesve të librit. Ajo qemë ka lënë përshtypje është shënimi i 21 marsit dita botërore e poezisë në bashkëpunim me DKA-në, mendoj se ky organizim është i mirëseardhur, por pyetja ime është: Nëse mbahet kjo ditë sa kohë më parë duhet të informohet opinioni sepse kjo është në interes të secilin nga ne që vije ajo fushë, pastaj në çfarë forme të leximit apo punimeve do të shënohet kjo ditë.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek Drejtoria për Shërbime Publike i pashë prioritetet e punës për vitin 2019, mua këto projekte më duken të ngjashme sikurse të viti të kaluar, sepse edhe ashtu duhet të ndërtohen kanalizimet, rrugët etj. Por ajo që nuk kam parë në këtë plan është se nuk ka ndonjë fushat ekstra për sigurinë e trafikut në rrugë, pra nuk ka ndonjë analizë të rrugëve të Rahovecit, cilat rrugë janë një drejtimesh në mënyrë që ta projektojmë një parking zero shkallë dhe ta shfrytëzojmë këtë rrugë për parking nëse është 4-5 metra e gjerë. Ka mundur të bëjë Kryetari ose Drejtori i Shërbimeve Publike një program deri në 20 minuta që të ligjërohet nëpër shkolla të Komunës së Rahovecit, për kulturën e komunikacionit. Në biseda formale me drejtorin i kam thënë se unë jam i gatshëm që të shkojë dhe të ligjëroj pa pagesë nëpër shkollat fillore rreth kulturës së komunikacionit. Kurse sa i përket Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit këto që i lexova kanë mbetur si shabllon, ish drejtori i kësaj drejtorie patë premtuar se do të hapet një klub i futsallit, hembollit, ne jem të gëzuar që është duke u hapur salla, por komuna jonë ka nevojë për këto klube, por jam duke parë që nuk ka ndonjë iniciativë. Flasë nga përvoja, për vete kam luajtur nëpër turnirë të ndryshme në Komunën e Rahovecit, drejtoresha nuk e ka idenë se sa fonde mundet brenda vitit të i grumbulloj nga organizimi i këtyre turnirëve besoj se deri në 10,000.00 €. P.sh nëse organizohet një turnirë për përvjetorin e Tonit dhe Micit dhe nëse shkon në ndonjë firmë të Rahovecit dhe i kërkon që të sponsorizon këtë turnirë besonin se me gjithë dëshirë do i jepe, posaçërisht kur i tregon se këto mjete do të shkojnë për bursa për fëmijët e dëshmorëve.

Florida Bajraktari – Desha të diskutoj rreth Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, tek gjendja civile thuhet se synimi ynë për këtë vite do të jetë rritja e shërbimeve edhe nëpër zyrat e qendrave civile. Të nderuar zyrat e gjendjes civile nëpër fshatra nuk kanë pajisje të mira të rrjetit, para disa dite kam qenë dëshmitare në një konorizim në zyrën e gjendjes civile në fshatin Hoçë e Vogël, në është dashur një orë që të presim që të shkarkohet dokumenti i cili i nevojitej, sipas zyrtarit të gjendjes civile pajisjet janë të vjetërsuara prandaj na shfaqen këto probleme.

Munib Durguti – Falënderojmë Kryetarin e Komunës që ka treguar gatishmëri për të na sjellë këtë Plan të punës për vitin 2019, besoj se kjo do të kontribuoj edhe në transparencën e punës së tij, po ashtu edhe cilësisë e cila mundet të rritet varësisht nga propozimet, vërejtjet që munden sot të jepen nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Por nëse shohim Planin e punë së Drejtorisë së shëndetësisë për vitin 2019, e shohim që

shumica e aktiviteteve janë vazhdimësi e atyre punëve që janë kryer në vitet e kaluara, është normale sepse edhe më parë ka qenë kështu, ka po ashtu edhe projekte të reja të cilët do fillojnë në këtë vit. Jemi duke parë gatishmërinë e drejtorit për funksionalizimin e repartit të dializës gjatë këtij viti, e mirëpresim këtë iniciativë, do të ndajë një informacion që kam pasur me më parë, ka mbetur edhe shumë pak punë që të bëhet repartit i dializës, është një vendim nga bordi spitalor i cili ka shpreh gatishmëri që deri sa të pranohen profesionistë e kësaj fushe, ata janë të gatshëm që të delegojnë profesionistë e kësaj fushe nga qendra spitalore e Prizrenit. Besoj se kjo informatë na ndihmon që kjo njësi të funksionalizohet në një fat sa më të shpejtë kohor, besoj se kjo duhet që të shfrytëzohet, ngase kemi dhjetë punëtor që një vite e gjysmë janë ngujuar në qendrën spitalore në Prizren, kurse ata janë pranuar për qendrën e dializës në Rahovec. Po ashtu propozoj që në kuadër të këtij plani drejtori të i inkadroj edhe profesionistët e tjerë shëndetësor në nivelin primarë shëndetësor komformë konkursit që e diskutuam në pikën e dytë. Ne erdhe në të kaluarën por edhe tani si kuvend duhet që të këmbëngulim që të risim sa më shumë profile të tjera që i mungojnë QKMF-së në Rahovec. Do të ndërlihdhesha edhe më diskutimin e z. Dervish Çardakut, i cili kërkoi që të jetë prioritet rritja e listës së laboratorit të analizave në Rahovec, ndajë informatën që në mes të vitit 2017 Ministria e Shëndetësisë e ka larguar kufizimin që e ka pasur për listën e analizave të gjakut për nivelin primar shëndetësor, kjo në jepe të kuptojmë se kjo na jepe mundësi që të bëjmë analiza aq sa kemi buxhet dhe aq sa kemi profesionist brenda qendrës së mjekësisë familjare. Gjatë këtij viti pritët të specializoj edhe biokimisti i cili është financuar nga komuna e jonë, kjo është një lajm i mirë, vetëm duhet që të ndahet një buxhet i qëndrueshëm, dhe sidomos kategorisë së pleqve të ju mundësohen analizat të cilat ata i kanë nevojë më së shumti.

Ali Morina – Falënderoj Kryetarin që na ka sjellë këtë Plan të Punës për vitin 2019, ku i kanë paraqitur planet dhe synimet për vitin 2019, konsiderojmë që një plan i tillë i punës paraqet synimet shumë të qarta, ne aspak nuk dyshojmë në realizimin e këtyre synimeve duke marrë parasysh vullnetin gatishmërinë dhe qasjen tuaj dhe të ekzekutivit ndaj punëve dhe ndaj qytetarit. Shpresojmë se në vitin 2019 të i jepen fund investimeve infrastrukturore, në mënyrë që vitet e ardhshme buxhetin ta orientojmë në investime zhvillimore për komunën tonë. Ne shpresojmë se ky vite do të jetë viti më i suksesshëm se viti 2019, sepse viti i kaluar shumica e projekteve kanë qenë të planifikuara nga qeverisja e kaluar dhe nuk është mundur të dilet jashtë këtyre planifikimeve.

Rasim Fazliu – Falënderoj Kryetarin e Komunës që na ka sjellë Planin e Punës për vitin 2019, desha ta pyes kryetarin kur i ka bërë këto planifikime për vitin 2019, duke e ditur se edhe ne e kemi bërë miratimin e buxhetit për këtë vit, a ka mbulesë buxhetore për të gjitha këto që i ka përshkruar në planin e punës. Në vitin e ardhshëm përsëri do na sillni raportin e punës për vitin 2019, ne pastaj do e marrim me vete këtë Plan të Punës për vitin 2019 ku do të shikojmë fletë për fletë se a janë realizuar këto detyra apo jo. Ne si kuvend komunal e kemi caktuar një lokacion për hedhjen e mbeturinave inerte, ne si kuvend e kemi marr vetëm një vendim, pyetje ime është deri ku keni arritur me punë rreth kësaj deponie, dhe kur do të filloj hedhja e mbeturinave në këtë lokacion sepse kjo do të ndikojë drejtpërsëdrejti në ruajtjen e mjedisit tonë, sepse edhe në raporte e keni cekur se mbi dhjetë deponi i keni pastruar nga mbeturinat inerte, prandaj është mirë që mos të lejohet më të gjuajnë mbeturina vend e pa vend por në lokacionin ku e kemi caktuar ne. Diçka tjetër që e kisha shtuar në këtë Plan të Punës së Kryetarit pra si propozim, diskutuam rreth futjes së taksës për mbledhjen e mbeturinave, pra do të ishte mirë që në vitin 2019 të bëjmë përpjekje dhe të fillojmë me mbledhjen e taksës nga komuna, në këtë mënyrë ritet edhe buxheti i komunës dhe me anë të kësaj ruhet mjedisi. Nga raporti që e kemi pasur nga kompania e cila e bënë grumbullimin e mbeturinave, ne jemi dëshmitar të asaj se më pak se 50% të ekonomive familjare paguajnë taksën për grumbullim të mbeturinave, kurse nëse kalon nën menaxhimin e komunës atëherë 100% e taksës do të grumbullohet, se si do të mblidhen mjetet është e caktuar.

Fehmi Cena – Këtë plan që e kemi para vete është një plan gjithëpërfshirës ku përfshihen të gjitha drejtorit, në këtë plan janë të cekura shumë synime, objektiva etj. Shpresoj se ky plan do të realizohet së paku pjesa më e mirë e tij të realizohet, kalojmë tek Zyra për Barazi Gjinore, për dallim nga Raporti i punës që ishte i paktë, tek planifikimi jemi duke parë që është voluminoz, ka mjaftë synime vetëm urojë që të punohet në këtë drejtim në mënyrë që të realizohen qëllimet që i ka kjo zyre. Kosha dhënë një propozim që kjo zyre të mirët edhe me familjet që gratë janë bartëse të familjeve dhe ato kanë nevojë në shumë aspekte që të ju dilet në ndihmë. Tek Drejtoria e Shëndetësisë nuk jam duke parë që e keni cekur Bashkëpunimin në shëndetësi, sepse çelësi i suksesit në shëndetësi është bashkëpunimi i mirë në mes Drejtorisë Komunale dhe Drejtorisë së QKMF-së, që ndonjëherë po çalon. Tek synimet e tjera z. Munib Durguti e ceku repartin e dializës, që e keni futur në prioritet, është mirë që të punohet në këtë drejtim në mënyrë që kësaj kategorie të njerëzve të komunës sonë të i jepet një zgjidhje, sepse puna ka mbetur në gjysmë. E kisha përmendur edhe një kategori tjetër të qytetarëve të cilët kanë të bëjnë me shëndetin mendor, janë disa pacientë me sëmundje psikike që i kemi, unë më parë e kam cekur qendrën e shëndetit mendor bazuar në bashkësi, është një institucion të cilën duhet të ketë komuna jonë sepse aty ata do të kenë edhe trajtimin por edhe qëndrimin ditor, por sa e di unë kjo nuk është përfshirë as në kornizën afatmesme buxhetore. Por ajo që mundet të bëjë komuna në këtë periudhë është që të del në ndihmë që ti sigurojnë ilaçet sepse ata i marrin ilaçet në mënyrë kronike çdo tre javë ose një muaj, kjo çështje më parë ka qenë e zgjidhur përmes regjionit kurse tani ata e kanë ndërprerë dhe diçka ka bërë komuna vitin që shkoj diku gjysmën e viti janë siguruar barërat për ta kurse gjysmën e vitit të dytë ata janë detyruar të i blenë vetë barnat. Sistemi i informimit shëndetësor forma digjitale nuk jam duke parë që është paraparë në synimet tuaja, mendoj se edhe kjo duhet të jetë, pastaj mjekësia familjare si koncept duhet të jetë etj. pastaj ajo që duhet të bëhet është integrimi i dy ambulancave të mjekësisë familjare minoritare, njëra gjendet në lagjen e epërme të Rahovecit, kurse tjetra gjendet në Hoçë të Madhe, neve mundet të na duket se ata janë të integruar, por e vërtete është se ata nuk janë të integruar. Neve na vinë pacient që janë kontrolluar tek këto ambulanca dhe ata gjithmonë janë duke përdorur fleta të bardha, pra nuk i përdorin recetat tona ose dokumentacionin tonë, pra ta nuk i respektojnë rregullat ligjore që do të duheshin të i respektojnë. Pastaj është edhe një synim që ne e quajmë promovim dhe edukim shëndetësor i qytetarëve, është mirë që të punohet me fletushka, me ligjëratat, me mjete të informimit, rreth disa çështjeve që ne më parë i kemi zbatuar. Janë disa sëmundje të caktuara i përmendi më herët dikush p.sh sëmundjet malinje si turbukuloza, duhani, droga, sidomos duhet që të punohet me rinin nëpër shkolla, pra duhet të ketë një bashkëpunim në mes DKA-së dhe DSHMS-së. Në kornizën afatmesme buxhetore ne e kemi kaluar një shërbim i cili quhet shëndetësi mobile (Kujdesi Shtëpiak), pra me anë të kësaj synohet që tu dilet në ndihmë pacientëve që kanë sëmundje kronike, në këtë plan këtë nuk jam duke e parë, kishte me qenë mirë të ishte. Sa i përket DKA-së, ne pak më parë kemi diskutuar dhe jemi pajtuar që më mirë kishte me qenë që të bëhen renovime të shkollave, e jo të ndërtohen objekte të reja sepse ato kanë koston e tyre të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes. Sa i përket bursave është shumë mirë që janë duke u ndarë, por kërkesa jonë është që të kemi qasje në ndarjen e bursave ne si anëtar të kuvendit, kjo do të ishte më mirë edhe për komunën sepse do të ishte më demokratike dhe më transparente. Tek arsimi ajo që nuk kamë parë në plan është ekskursioni i maturantëve për të cilën ne kemi diskutuar më parë, dua ta di a është anuluar kjo apo i ka ikur drejtorit që të fusë këtë pjesë. Tek Drejtoria e Urbanizmit Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, janë synimet që ne i përkrahim, por ajo që nuk e shohë është renovimet dhe fasadimet e objekteve në qytet, deri më tani janë bërë por këtu në këtë plan nuk ekziston diçka e tillë, mendoj se qyteti i Rahovecit ka nevojë ende që të bëhen fasadimet e disa objekteve të banimit kolektiv, por kishte me qenë mirë që ato kur të rregullohen të rregullohen mirë, e jo të kemi vërejtje së më parë që janë rregulluar disa objekte dhe një kohë e keqe të bie gjysma e kulmit në tokë. Pastaj nuk jam duke parë në plan sipërfaqe të gjelbëruara, këtë vite ka pasur mbjellje të sipërfaqeve të gjelbëruara si në fshatra ashtu edhe në qytet skaj rrugëve, por ajo që më intereson është a ka mirëmbajtje të mëtutjeshme ndaj tyre sepse nëse nuk ka përkujdesje ato shumë shpejtë mundin të

thahen. Tek Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, përmendet një vend Themelimi i Komisionit për Komasacion, çka nënkupton dhe çka përfshin ky komasacion, konkretisht çka do të punoj ky komasacion. Drejtoria për Shërbime Publike gjithashtu ka mjaftë synime, ceket diku rrjeti i ujit të pijes për fshatrat Zatriq, Babovc, Mrasor, mendoj se kjo duhet të jetë prioritet mbi prioritete sepse uji i pijes është diçka që duhet të kenë çdo qytetar i yni, mendoj se komuna duhet të investoj brenda vitit tek të gjitha ato vendbanime që nuk kanë ujë të pijes. Është një pikë këtu që ceket se si bëhet largimi i qeneve endacak, po ashtu edhe forma me pjesëmarrje të AVUKUT nga niveli qendror, por ajo që më intereson është se në komunën tonë a është ndonjë projekt i cili bënë kujdesin ndaj këtyre qenve. Përmendet diku edhe Eutanazia që është përdorur tek ne forma e mbytjes së tyre, çka jeni duke menduar rreth kësaj forme, ne kishim mundur të bisedojmë se cilat kafshë kishim mundur të i përfshimë me eutanazi, por gjithmonë sipas standardeve, pastaj a keni menduar që të keni edhe buxhet nga komuna apo vetëm nga niveli qendror. Ne kemi mjaftë raste të cilat na vinë në QKMF nga kafshimet e qenve. Sa i përket vendosjes së remtit tokësor nga ana e Kedsit, e kam dhënë edhe më parë një vërejtje ku vendosja e ormanëve nga ana e tyre në shumicën e rasteve është vendosur jo në bazë të kriterëve mendoj, sepse disa janë vendosur paralel me rrugën, disa në mënyrë trans verze frontale, ku pengojnë kalimtarin ,pastaj trotualet janë uzurpuar me këto ormane. Tek Drejtoria për Bujqësi është bërë një plan i mirë, ashtu siç e kemi kërkuar ne në baza tremujore, ne i mbështesim të gjitha këto synime që i ka paraparë kjo drejtori, ne dimë se sa është buxheti në bujqësi dhe urojmë që ky buxhet të realizohet në fushën e bujqësisë dhe besoj se do ti dilet në ndihmë këtij sektori i cili është shumë i rëndësishëm për komunën tonë dhe popullatën tonë. E keni cekur edhe mbrojtjen e pyjeve, pastaj rritjen e sipërfaqeve me pyje të reja, mendoj se edhe këtu është me rëndësi që sipërfaqet e pyjeve të mbillen sepse Rahoveci ka nevojë sepse pyjet janë shumë të dëmtuara. Do të diskutoj edhe për Drejtorin për Kulturë Rini dhe Sport, prioritet që unë i japë shumë është pjesa e trashëgimisë kulturore, për arsye se kemi mjaftë objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore që koha është duke i rrezikuar, prandaj shumë është me rëndësi se kur duhet të veprohet në mënyrë që të mbrohen. Edhe sa i përket pjesës së ngjalljes së jetës kulturore artistike ne e përkrahim, angazhimi dhe synimi për hapjen e teatrit rinorë, është mirë të punohet rreth kësaj dhe jo të mbetet vetëm në letër, pastaj të përkrahet shkolla e muzikës, grupet muzikore, të aktrimit, në mënyrë që të rritet jeta kulturore dhe artistike në komunën tonë.

Hanalora Hoti – Desha të ndërlihem tek prioritetet e Drejtorisë për Shërbime Publike, që i kanë planifikuar për vitin 2019, pikërisht tek pika kyçe e mirëmbajtjes së hapësirave publike. Të nderuar në shkollën fillore në fshatin Ratkoc është për të ju ardhur keq që emrat e dëshmorëve të cilat janë të shkruara në ato pllaka të vogla, tash e një kohë janë të hequra, kishte me qenë mirë mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e tyre mbase besoj se nuk kanë ndonjë kosto të madhe.

Mirjeta Krasniqi – Sa i përket Planit të punës tek zyra ligjore apo avokatura, duke e parë që në raportin e viti 2018 kemi parë që rreth 32 milion e gjysmë komuna ka qenë e paditur, a mendoni se në planin e punës së viti 2019 do të kemi gjendjen më të mirë. Pastaj a e keni paraparë që komuna të jetë më e organizuar dhe të jetë më shumë paditëse se sa e paditur, pasi që në vitin 2018 kemi rreth 792 lëndë si e paditur dhe vetëm 14 si paditëse.

Isak Hoti – Të nderuar do ta kemi situatën e njëjtë edhe këtë vit do të mbesin edhe këtë vit 32 milion, për arsye se në këtë mes është paditur Komuna e Rahovecit, qeveria e përkohshme, sepse qeveria e përkohshme nuk e ka pasur të drejtën e sigurisë në atë kohë, por e ka pasur KFORI dhe UNMIKU. Paditë janë bërë në gjykatën e Rahovecit, ne faktikisht me letra jemi diku 3332 milion të paditur, por këto lëndë nuk do të shqyrtohen asnjëherë për arsye se në marrëveshje të Ohrit shkruan se KFORI dhe UNMIKU nuk mundën të paditen, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës nuk e ka pasur sigurinë në atë kohë.

Kryetari – Besoj se Plani vjetor i Punës për vitin 2019 është një standard që ne po e aplikojmë dhe do të aplikohet çdo vit, jam dakord me ato shqetësime që u ngritën nga anëtarët e kuvendit se është më lehtë të bëhet ai instrument matës midis raportit vjetor të punës dhe planit vjetor të punës. Në nga të gjeturat e

auditimit të jashtëm ka qenë edhe mungesa e planeve, ju mundeni të shihni raportin për vitin 2017 dhe ne është dashur të i zbatojmë rekomandimet e auditorëve të jashtëm. Plani vjetor i punës për vitin 2019 përmban synimet, qëllimet, prioritetet dhe aktivitetet thelbësore të cilat do të duhej të përqendrohej komuna e Rahovecit në mënyrë që të plotësohen maksimalisht, janë disa prioritetet në këtë plan të cilat nuk lidhen vetëm për një vite, ka disa aktivitete të cilat do të përsëriten sepse janë disa tema të mëdha që nuk mundën të kryhen brenda një viti. Ju siguroj se synimet të cilat ne i kemi vendosur në Planin e Punës për vitin 2019 janë të harmonizuara maksimalisht me kornizën afatmesme buxhetore ose buxhetin e vitit 2019, natyrisht ka edhe veprime dhe prioritetet të cilat duhet të ndodhin në perspektivë dhe që nuk mundën të përmbillen brenda një viti sepse është normale. Dita Ndërkombëtare e Poezisë ka një traditë në Komunën e Rahovecit e cila mbahet me 21 mars, besoj se edhe kësaj radhe ne do të bëjmë këtë ditë, mënyra ose metodologjia që mundet të aplikohet mundet të jetë e ndryshme nga viti i kaluara, ne jemi të interesuar që kjo të pasurohet dhe kushdo që ka mundësi të jepe kontribute në këtë drejtim është i mirëseardhur. Plani i punës nuk e precizon sigurinë në trafik, ne jemi të vetëdijshëm dhe të informuar, besoj se këtu ka nga ata të cilët marrin pjesë në plotë aktivitete të cilat bazohen në një program të cilin e ka policia e Kosovës, pastaj organizatat joqeveritare, DKA-ja, ku flasin dhe ligjërojnë për sigurinë në trafik, lindë pyetja a është e mjaftueshme, sigurisht se jo. Shpresoj se do të kemi mundësi që ta pasurojmë sfondin e angazhimeve që siguria në trafik me u konceptu më qartë dhe më aktiv në mënyrë që vërtet të i eliminojmë plot të meta të cilat janë për momentin. Ne në plan të punës nuk mundemi të i vendosim projektet, p.sh projekti se si kishte të vepronte një mbarëvajtje më të sigurt të qytetarëve dhe makinave të cilat janë në trafik. Ne sa i përket parkingjeve publike do të mbajmë edhe debate publike, ne e kemi një kod në buxhetin e vitit 2019, në listën e prioritetëve ose prioritetëve kapitale ka po ashtu edhe një kod për sheshe të reja në qytet, pastaj ka për hapësira të reja, ndoshta edhe pas një analize edhe për ndryshimin e regjimit të qarkullimit të automjeteve në trafik. Nëse do të kemi situata të tilla i nderuari z. Vahid Krasniqi je i ftuar që të maresh pjesë dhe të japësh kontributin tënd në drejtim të dizajnit sa më të mirë të pozicioneve që kanë të bëjmë me hapjen e parkingjeve të reja etj. Tek aktivizimi i klubeve të reja si Futsalli, hendbolli etj, ne si komunë nuk mundemi të iniciojmë zyrtarisht formimin klubeve të reja, por nëse ka vullnet për të ndërmarrë kështu iniciativa atëherë fatmirësisht palestra e sporteve në Rahovec po hapet, besoj se kjo do të jetë një stimulim për tu formuar klubet e reja sepse palestra nuk është vetëm e basketbollit por është e të gjitha disiplinave tjera të cilat mundën të zhvillojnë aktivitete sportive. Ne si komunë i inkurajojmë që të formohen këto klube dhe do ti mbështesim me kapacitetet tona si komunë me anë të kodit për subvencione nga drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Tek palestra dhe mirëmbajtja e objekteve sportive në rastin konkret përderisa të përgatitet rregullorja e cila do të vije në kuvend për mirëmbajtje të palestrave, ne deri atëherë do i angazhojmë punëtorët e Drejtorisë së Kulturës së bashku me operatorin, deri sa të fitojmë një përvojë të mirëmbajtjes. E nderuara znj. Florida Bajraktari ne në bashkësi lokale ku i kemi zyrat e ofiqarisë pretendojmë që të kemi avancim të shërbimeve, ne deri në gjysmën e vitit 2018 në ambientet e Komunës këtu në këtë objekt nuk ka pasur as dhomë për kurorëzime, kjo është gabim dhe ne është dashur ta rregullojmë një zyre për së këtë punë, e kemi bërë një rregullim modestë, ne këtë duhet të bëjmë edhe në zyrat e bashkësive lokale sepse edhe atje mundemi të kemi shërbime të kësaj natyre. Reparti i Hemodializës ka pasur ngecje ne jemi dëshmitar se kur një shërbim i cili është i karakterit sekondar deri sa të finalizohet ka telashet e veta, besoj se edhe për këtë z. Munib Durguti dhe shumë prej nesh jemi të informuar, ka pasur një tendencë që stafi që është trajnuar nga qeverisja e z. Vehapi të përjashtohet nga loja, natyrisht se ne kemi këmbëngulur që nuk bënë sepse 10 muaj të i qosh njerëzit në trajnime dhe pastaj të i thuash shkoni në shtëpitë tuaja, kjo mendoj se nuk është në rregull. Ne edhe në vitin e kaluar e kemi pasur synimin që të hapim këtë repart, por nuk kemi mundur të mbërrimë, besojmë dhe shpresojmë se këtë vite do të kryhet edhe kjo punë. Ne do të kemi konkurse për punëtor shëndetësorë sepse siç ju thashë më parë ka rritje të stafit të punonjësve shëndetësor dhe kjo është një arritje e madhe. Sa i përket analizave në laborator, unë kam vërejtje sa i përket këtij stafi i

cili bënë analiza, unë ja kam thënë në sy këtë edhe atyre, unë e kam atë person shok lufte por ne duhet të definojmë se çka është duke ndodhur aty, dhe nëse këtu nuk funksionon si duhet mëno se ndoshta nuk është problemi gjithmonë tek mungesa e atyre materieve që i dedikohen atyre analizave sa është një farë mungese e përgjegjësisë. Neve tani po na kthehet nga specializimi biokimisti dhe shpresoj se do të mundemi të avancojmë në zgjerimin e shërbimeve të analizave në laborator dhe shtimin e besimit. I nderuar z. Rasim Fazliu mbulesa buxhetore gjithnjë mundet të jetë e dëshiruar, për arsye se ne jemi në një situatë që planet tona janë ambicioze, por nganjëherë mundemi të përballemi me deficit buxhetor, por ne duhet të luftojmë që të kemi sa më shumë mbështetje që deficite buxhetore mos të kemi në investime kapitale. Sa i përket deponisë së mbeturinave të ngurta, kuvendi i komunës ka vendosur, ko deponi është certifikuar nga ministria përkatëse, tani ka mbetur vetëm një situata se a do të ndjekim një rrugë gati 1km dhe ta shtrojmë me zhavorr që të shkojmë deri tek kjo deponi, apo duam ta trajtojmë një rrugë tjetër e cila është 100 m por që është pronë e Stone Castles , ne kemi mare aprovim ose leje nga Stone Castle për këtë rrugë, dhe jemi pro që kjo rrugë më e shkurtë të jetë deri tek kjo deponi, prandaj besoj se këtë vite ne këtë deponi do ta aktivizojmë. Taksa për mbledhjen e mbeturinave, ne do të provojmë me drejtorit të cilët i prek kjo taksë që të bëjmë grumbullimin e mjeteve, por duhet të dini se është bukur komplekse situata për të filluar implementimin e një projekti i cili ka filluar mbarë në Prizren, por përsëri nuk është duke funksionuar na bazë të atij standardizimi ose marrëveshje që e potencoi z. Rasim Fazliu. Sa i përket zyrës për barazi gjinore ne shumë shpejtë do ta sjellim në kuvend një informatë se cili është raporti gjinorë në Komunën e Rahovecit në të gjitha sektorë, po ashtu jam pro asaj që gratë mbajtëse të familjes të kenë një përkrahje jo vetëm në biznes por edhe në organizata të tjera. Pastaj Bashkëpunimi i DSHMS dhe QKMF, mendoj se ka ekzistuar dhe ekziston, po ashtu mendoj se ka me u thellu edhe më shumë, por kam një mendim se drejtorin aktual të QKMF-së punëtorët nuk e dëgjojnë shumë, edhe pse ai si njeri më është dukur shumë i mirë, mendoj se ka nevojë që të ja japim një përkrahje ma korrekte dhe më të sinqertë. Do të ritet fokusi jonë drejtë QKMF-së, po ashtu do të ritet edhe prezenca jonë në vizita herë me orare dhe herë pa orare drejtë QKMF-së. Shëndetin mendor nuk e di a mundemi ne ta aktivizojmë atë marrëdhënie që e ka pasur QKMF-ja me spitalin mendor, ne duhet të shohim se a mundemi ende me e avancu këtë, pastaj duhet të shohim sigurimin e barnave për njerëzit që kanë sëmundje kronike ose për ata që kanë probleme me shëndet mendor. Kurse qendra për qëndrim ditor është një avancim në proces dhe nëse mbërrimë deri këtu atëherë ne duhet që ti fusim në lojë edhe disa faktor të tjerë si policia dhe qendra për punë sociale etj. Sa i përket regjistrimit informativ shëndetësor, ju vetë e keni pranuar në një takim që kamë qenë dhe unë prezent, ku keni thënë se disa kanë punuar shumë ku na kanë bërë me dije që është duke shkuar mirë, kurse disa të tjerë nuk janë lodhur fare për këtë punë. Meqenëse është donacion kjo dhe është prioritet në tërë Kosovën, mendoj se duhet të përkushtohemi më shumë sepse kjo ndoshta varet edhe prej njerëzve që punojnë aty. Nuk e kam ditur që dy ambulanca në Rahovec njëra në lagjen e epërme njëra në Hoçë të Madhe nuk është e integruar, mirë është që u përmend dhe tani unë e kam më të qartë dhe do të punoj së bashku me Drejtorin e Shëndetësisë që të gjejmë mekanizma që këto dy ambulanca të integrohen në sistemin unik shëndetësor të Republikës së Kosovës. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës ne pranojmë dy gjuhësinë gjuhën shqipe dhe serbe, sepse janë dy gjuhë zyrtare, por jo të jenë me qirilic, ky nuk është standard që aplikohet në Kosovë dhe ne nuk do ta tolerojmë këtë. Tek promovimi i fushatave sensibilizuese ato ndodhin, pavarësisht që nuk mund të jetë pikësynim ose prioritet, por e di që fushatat promovuese do të vazhdojnë të bëhen. Sa i përket Caritas Kosovës e keni aty por tani e ka një emërtim ndryshe, ne e kemi shpallur tenderin sepse për herë të parë kujdesi ambulator shtëpiak me persona që janë me regjim shtrati është duke u shpallur me tender sepse kjo është duke u kërkuar nga auditorët e jashtëm, çdo shpenzim që bëhet nga mallrat dhe shërbimet ata janë duke kërkuar që të shpallen procedurat e prokurimit sepse donë që ta afirmojnë konkurrencën. Sa i përket renovimit të objekteve shëndetësore ne vitin kaluar kemi bërë diçka, por ne përveç renovimit kemi edhe ndërtim, ne do ta ndërtojmë qendrën e mjekësisë familjare në fshatin Çifllak, ne nuk mundemi me i ikë kësaj

teme sepse është në gjendje mizërie. Fasadimi i objekteve publike do të vazhdoj, arsyeja pse nuk e kemi futur në plan të punës është sepse ky është një projekt i cili qoftë bëhet nga ministrinë përkatëse, çoftë edhe me bashkëfinancim ministri – komunë, ky projekt vazhdon edhe për këtë vit ku do të fasadohen objektet publike, po ashtu do të kemi edhe projekte të efijencës së energjisë për objektet publike. Komisioni për komasacion, ne si komunë kemi disa probleme me komasacion, por problemin më të madh e kemi në fshatin Krushë e Madhe, ne duhet të ngrisim një komision i cili do të operoj në bashkëpunim me Ministrin e Bujqësisë, komunitetin e atij vendi dhe agjensionin kadastral të Kosovës. Krushianët janë duke e përjetuar në kurriz çdo ditë sepse nuk munden të i realizojnë shumë grande për arsye të kësaj situate që e kanë. Sa i përket ujit të pijes ju e dini se ne marrim pjesë në marrëdhënie me KRU- Gjakovën 49 %ne 51% KRU- Gjakova, shpresojmë se do ta mbyllim ciklin e investimeve në ujë të pijes ndoshta këtë vit, pastaj ne do të mundemi të hymë në avancim të sigurimit të ujit të pijes edhe në pjesët e caktuar të qytetit, po ashtu edhe në ndonjë zonë kodrinore. Tek qentë endacak është AVUK i cili vepron në shkallë të republikës së Kosovës, është e vërtetë që ka vepruar edhe në komunën tonë, po ashtu është e vërtetë që qentë endacak ka sa të duash në komunën tonë dhe plotë komuna të tjera. Asnjë komunë e republikës së Kosovës nuk ka mundësi më të përdorë metodën e eliminimit të qenve endacak me anë të ekzekutimit sepse është në kundërshtim me ligjin për përkujdesje ndaj kafshëve. Sa i përket ormanëve ne nuk i vendosim, ato i vendos KEDSI përmes operatorit kontraktues, po të ishim në Gjermani apo Austri këso ormanë nuk kishim me i vendos, por Kosova ka probleme sepse ka bërë marrëveshje kur e ka privatizuar KEDSI-in, e gjitha çka mundet të bëjë komuna është që ti dele në ndihmë që mos të kenë probleme kur do ti vendosin ormanët, asnjë përgjegjësie tjetër ne nuk e kemi. Sa i përket mbrojtjes së pyjeve ne kemi edhe në vitin 2018 i kemi pyllëzuar sipërfaqe të mëdha, po ashtu edhe në vitin 2019 do të vazhdoj pyllëzimi i sipërfaqeve, por këto janë projekte që i bënë agjensioni i cili e ke selinë në Pejë dhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të një plani dhe në bazë të kërkesave tona. Sa i përket trashëgimisë kulturore dhe historike, ne kemi në planet tona edhe projekte të cilat lidhen me trashëgimi kulturore, me muze, me monumente të natyrës, krojeve, pastaj restaurimin e tyre, krijimi i muzeut të masakrës në Krushë të Madhe, muzeu Ukshin Hoti. Do të provojmë të gjejmë mbështetje edhe për renovimin e objekteve të vjetra si kullat në qytet, pastaj do të shohim se a do të kemi mundësi të vazhdojmë me projektin e restaurimit të pjesës së vjetër të qytetit etj. Teatri rinor është sfidë sepse nuk është bash e thjeshtë, ne në bashkëpunim me SHHL- Kosova kemi aplikuar në Ministrin e Kulturës në thirrjen për aplikim, tani presim të shpresojmë se do të fitojmë këtë projekt. Dhe krejt në fund dua të ju them se ky plan është ambicioz por ne jemi të bindur se është realistë, dhe nënkupton angazhim maksimal me të gjitha kapacitetet që i kemi edhe si qeveri lokale, edhe si Kuvend i Komunës, por edhe si Kryetar i Komunës, qoftë prej Qeverisë së Kosovës qoftë edhe me donatorë të jashtëm, qoftë edhe me kapacitetet tona do ti realizojmë këto synime, sepse askush ma shumë se ne që jemi këtu nuk është i interesuar që të i realizojmë planet e mira zhvillimore komunale, dhe të kemi një qeverisje të suksesshme.

Fehmi Cena – Sa i përket ormanëve që janë vendosur nga Keds, rruga nga e kam edhe unë shtëpinë janë të vendosura nëpër trotuare. Rahoveci ka pak trotuare dhe nëse ne i lejojmë që të vendosen ormanët në trotuare atëherë në Rahovec nuk do të ketë më trotuare. Duhet të bisedohet me zyrtarët e KEDSIT, sepse unë e kam parë që në ato ormanë janë të vendosura njësorët, ne tel lagja jonë këto ormanë i kemi vendosur në rrugët tona ose në oborre tona sepse ato janë njësorë tanë, por të tjerët nuk lejojnë që këto ormanë të vendosen në oborre të tyre, bisedojnë me ata zyrtarë të asaj kompanie dhe i vendosin në trotuare, aty janë disa njësorë kuptohet por duhet familjarët që të merren vesh. Kishte me qenë mirë që të merrni seriozisht dhe të dilni në teren që ta shikoni gjendjen se si është.

